

UR TËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM ISELISË SË SHËNJTËTË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.126 QERSHOR 2018



Lartësim i shpirtit

Muaji i Ramazanit është muaji ku Allahu i shumëfshon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ita në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinjeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti.. virtute këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimin në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore...



LARTËSIM I SHPIRTIT

Muaji i Ramazanit është muaji ku Allahu i shumëfshon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ita në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinjeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti.. virtute këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimin në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore...

LARTËSIM I SHPIRTIT

Muaji i Ramazanit është muaji ku Allahu i shumëfshon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ita në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinjeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti.. virtute këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimin në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore...



SHQIPËRIA, model i harmonisë fetare

Krëjtë e besimeve nënkrijnë marrëdhënien e bashkëpunimit

SHQIPËRIA, model i harmonisë fetare

Krëjtë e besimeve nënkrijnë marrëdhënien e bashkëpunimit

SHQIPËRIA, model i harmonisë fetare


Krëjtë e besimeve nënkrijnë marrëdhënien e bashkëpunimit

SHQIPËRIA, model i harmonisë fetare

Krëjtë e besimeve nënkrijnë marrëdhënien e bashkëpunimit

Shqipëria, model i harmonisë fetare

Ne datën 3 maj 2018, në mjediset e Hotel Rogner International, në Tiranë, u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare për dialogun midis besimeve: “Shqipëria, një model i harmonisë ndërjetare për Evropën”. Organizatorët e saj, me mbështetjen e Ambasadës së Austrisë në vendin tonë, ish-in Universiteti “Beder”, Kolegji Universitar “Logos” dhe Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”...



VIZATIM NGA FRASHËRI

Vizatim nga Frashëri

VIZATIM NGA FRASHËRI

Vizatim nga Frashëri

Vizatim nga Frashëri

Sic është pranvera, nga më të bukurat e Stinës, mozaiku shumëngjyres të tërheq dhe këtë e ndjen në mëngjesin e veçantë, sapo futesh në mjedisin e mrekullueshëm të Bredhit të Hotovës. Këtu ndjen ajrin magjik, aromën e luleve të shumta, shikon burimin në anë të rrugës, ku ka pirë ujë Nairi. Ashtu me mendjen e kthjelltë arrin në fshat...



Tradita Bektashiane mahnit Parisin

Mërsa nga shfaqja “Ditë e kulturës bektashiane” që zhvillova për të tretën vit rradhë në “La Palata” në kryeqytet e kulturës bektashiane

Tradita Bektashiane mahnit Parisin

Mërsa nga shfaqja “Ditë e kulturës bektashiane” që zhvillova për të tretën vit rradhë në “La Palata” në kryeqytet e kulturës bektashiane

Tradita Bektashiane mahnit Parisin

Më 28 maj 2018, Selia e Shenjtë Bektashiane, në bashkëpunim me Ambasadën e Shqipërisë në UNESCO, si dhe shtëpinë botërore të sufijve, organizon “Ditën e kulturës bektashiane” në një numri të madh artdashësish nga Franca, Italia, Turqia dhe Shqipëria...

LARTËSIM I SHPIRTIT



Muaji i Ramazanit është muaji ku Allahu i shumëfishon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ita në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinqeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti.. virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimin në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit. Profeti Muhamed (s.a.s.) thotë: “Gjumi i agjëruesit vlerësohet si adhurim, kurse heshtja si tesbih (madhërim i Zotit). Mirësive dhe adhurimeve të tij u jepet shpërblim shumëfish. Allahu ia pranon lutjet dhe ia fal mëkatet”

Në aspektin shpirtëror dhe të edukimit të egos agjërimi i muajit të Ramazanit është nga pikat e para të themeleve të besimit në fenë Islame. Ai ka disa anë të dobishme sidomos në aspektin shpirtëror,

edukimit të nefsit (egos, unit), si dhe për të shprehur falënderimin ndaj Allahut (xh.sh.), për mirësitë që na ka dhënë.

Njerëzit, nën perden e pakujdesisë të të mirave materiale, nuk arrijnë të vlerësojnë dhe të çmojnë të mirat e Allahut (xh.sh.). Zoti me urdhrin e agjërimin të Ramazanit, i shtyn besimtarët të vihen si në pozitën e një ushtrie. Ai i fton besimtarët të marrin pjesë në një adhurim dhe festë të amshueshme. Ata dalin dhe presin ftesën e iftarit me fjalën e ezanit të akshamit, duke thënë: “Allahu Ekber!” Përkundrejt kësaj situatë të bukur të Mëshirshmërisë së gjerë të të Gjithmëshirshmit, besimtarët përgjigjen me një rregullsi dhe përsosmëri të shkëlqyer. Të gjithë besimtarët në momentin e iftarit, përpara sofrës presin urdhrin e Krijuesit të Madhëruar.

Nuk mund të merret me mend se sa çmenduri është të shpërblesh shërbëtorin për arsye se ka sjellë dhurata nga mbreti, duke mosvlerësuar atë që i ka dërguar, si dhe në mënyrë të pakujdesshme t'i

nënvlerësosh ato, kur dihet që ato dhurata kanë vlerë të jashtëzakonshme. Pra, duhet pranuar se Allahu i Madhëruar, përballë mirësive që ka ekspozuar në faqen e tokës, kërkon falënderime nga njerëzit. Duhet ta falënderosh Atë, duke i pranuar mirësitë drejtpërdrejt nga Furnizuesi i Madhëruar dhe duke e ditur se kush është Pronari i vërtetë, e kështu të përcaktosh vlerën e tyre. Kjo do të dalë në pah atëherë kur e pranoni nevojën ndaj tyre, e cila vlerësohet vetëm kur agjëron.

Nefsi i njeriut nga pakujdesia e harron vetveten, sepse mban dobësinë, varfërinë e pafundme dhe paftësitë e panumërta. Ai nuk do që t'i shohë ato dhe ta kuptojë se është një i varfër që mund të shkojë drejt zhdukjes. Ky është edhe thelbi i fatkeqësisë, sepse ai është një krijesë që është krijuar prej mishi dhe kocke, që do të prishet së shpejti dhe do të ndahet. Ai mendon se ka një trup prej çeliku, që kurrë nuk do të zhduket, prandaj sulet pas interesave të kësaj bote, duke imagjinuar se nuk do të vdesë. Me një ambicie të tmerrshme dhe me një lidhje të fortë pas kësaj bote, bën çdo përpjekje. Tërhiqet pas çdo gjëje që është e shijshme dhe e vlefshme, duke e harruar Krijuesin që e edukon me mëshirën e pasosur. Më në fund rrokulliset në moralin e keq, duke mos menduar për përfundimin e jetës, sepse edhe ai do të vdesë një ditë dhe do të ikë në jetën e përjetshme. Agjërimi i Ramazanit u tregon dobësinë mosmirënjohësve, varfërinë dhe pakujdesinë e tyre. Për shkak të urisë ata mendojnë stomakun dhe e pranojnë nevojën e tij. Me anë të urisë së agjërimin, njeriu

e kujton se sa mashtrues është trupi i tij dhe e pranoni se ka nevojë për Mëshirën e Allahut (xh.sh.). Uria e shtyn të braktisë idhujtarinë e nefsit dhe të pranojë dobësinë dhe varfërinë e tij. Në këtë mënyrë i zgjohet dëshira që të mbështetet në praninë e Allahut (xh.sh.). Ramazani është një model ekspozite dhe shumë fitimprurës për jetën e përjetshme. Për të mbledhur prodhimet e jetës tjetër, ai është si shiu i prillit në pranverë. Prandaj ndaj mirësive të Zotit (xh.sh.), është si një festë dhe parakalim zyrtar. Ky është një shkak i arsyeshëm për t'i urdhëruar muslimanët të agjërojnë Ramazanin dhe të mos i shtojnë pakujdesitë. Të mos jenë të pangopur ndaj ushqimit dhe pijes, larg nefseve dhe nevojave kafshërore dhe orekseve të papëlqyera. Kështu urdhërohen që për një kohë të shkurtër të braktisin veset kafshërore dhe t'u shëmbëlajnë melekëve të pamëkatë. Ndoshta njeriu duhet ta mendojë se ka hyrë në tregtinë e jetës tjetër, për

të mbledhur prodhimet e saj, prandaj le të bëhet njeri i pamëkatë për një farë kohe. Shpirtërisht le t'i braktisë nevojat, duke pranuar dobësinë dhe varfërinë e vet.

Për jetën individuale, agjërimi është një ilaç me shume efekt. Nga pikëpamja mjekësore është një dietë e mirë, sepse njeriu kur ha më tepër se sa duhet dhe pa kontroll, e dëmton stomakun, gjë që mund t'i shkatërrojë shëndetin. Duke gjykuar në këtë formë, ai mund të bëhet i pavëmendshëm edhe për ushqimet e palejuara, gjë që do ta shqetësojë shumë shpirtërisht, jo vetëm për këtë jetë por edhe për tjetrën. Kjo vepër e papëlqyer bëhet shkak që zemra dhe shpirti

të mos u binden urdhrave të fesë Islame. Në këtë moment nefsi i pakujdesshëm i merr në dorë frerët e njeriut dhe e sundon atë, duke e çuar ku të dojë vetë.

Me agjërimin e Ramazanit njeriu mësohet të mbajë dietë. Kështu nefsi mësohet t'i bindet urdhrave dhe stomaku i dobët e fatzi shpëton nga pesha e rëndë e bluarjes, i cili bëhet shkak që njeriu të sëmuret shpesh. Njeriu gjatë muajit të Ramazanit disiplinohet, që ai të mos i sulet haramit duke braktisur hallallin. Ai e mëson njeriun ta kuptojë se qëllimi i krijimit të tij është të mos e shkatërrojë jetën shpirtërore.

Njeriu në jetën e tij në shumë raste përballlet me urinë. Agjërimi i Ramazanit është një lloj ushtrimi, që ia kalit durimin njeriut. Ai zgjat rreth pesëmbëdhjetë orë në ditë dhe po të mos hahet syfy, ai zgjat njëzetekatër orë. Pra, për të kalitur durimin, ky është një ushtrim shumë i mirë dhe një ilaç për atë që nuk duron dot fatkeqësinë dhe nuk ka rezistencën e duhur. Profeti (a.s.) thotë: "Agjërimi është gjysma e durimit, kurse pastërtia është gjysma e besimit"

Në muajin e Ramazanit muslimanët shpirtërisht përparojnë në shkallë të ndryshme dhe sipas meritave fitojnë gëzime, qetësi dhe lehtësira të zemrës. Zemra, shpirti, mendja dhe sekretet e shqisave të besimtarëve në muajin e Ramazanit përsosen dhe fitojnë shumë ngushëllime shpirtërore.

Pikësynimin kryesor agjërimi i Ramazanit drejtpërsëdrejti, e ka të thyjë faraonësinë dhe imagjinatën prej idhulli të nefsit, duke i bërë të njohur atij dobësinë, varfërinë e pafuqinë, në mënyrë që të fillojë të kryejë adhurimin ndaj Krijuesit të

tij. Ai e njofton se është një rob dhe asgjë më tepër.

Agjërimi është lartësim i shpirtit, ushtrim për përforcimin e trupit dhe nxitës për bamirësi. Ai synon ngritjen e ndërgjegjes së individit,

ndriçimin e mendjes dhe zbardhjen e zemrës. Ai është një institucion edukativo-moral, i cili synon edukimin fizik e shpirtëror të njeriut ku e përgatit atë përballë sprovave me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Nëpërmjet agjëritit njeriu aftësohet për të disiplinuar dëshirat e tij dhe ka vullnet e fuqi për të kryer çdo punë me përpikëri. Ai përsos aftësinë fizike dhe lartëson virtytet morale duke kultivuar të përshtaturit me kushtet e ndryshme social-ekonomike të jetës së përditshme. Duke agjëruar njeriu mënjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar në agim dhe në perëndim të diellit, largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri.

Devotshmëria është qëllimi i vërtetë i agjëritit dhe nëse e kuptojmë dhe e pranojmë si qëllim kryesor, atëherë më pas, do të gjejmë të gjitha frytet dhe dobitë e tij. Objektivi final i agjëritit është mirëqenia e njeriut dhe lumturia e tij në të dy botët.

Të privosh vetveten nga gjërat thelbësore të jetës, nuk është një akt i lehtë. Kjo kërkon një personalitet të fortë për të patur një vetëkontroll, vetëdisiplinë dhe vetëpërmbytje. Ky program vet ushtrues gjatë muajit të Ramazanit, ka rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Një besimtar që mund të përmbajë veten nga gjërat thelbësore të jetës për një kohë të caktuar dhe kur këtë e bën për hir të dashurisë për Allahun, meriton një shpërblim nga vetë Krijuesi. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: “Ka shumë njerëz që agjërojnë, e nga kjo nuk kanë asgjë, përveç urisë dhe etjes. Ka shumë njerëz që luten natën, e asgjë nuk ka nga kjo lutje, përveç pagjumësisë, i këtille është çdo njeri, i cili nuk e kryen këtë veprim me besnikëri dhe sinqeritet të plotë” (Ibn Maxhe, Sijam, 21).

Gjatë agjëritit në muajin e Ramazanit, myslimanët mësohen të kontrollojnë emocionet e tyre dhe të kenë durim, durim ndaj të gjitha llojeve të sprovave

dhe shqetësimeve. Agjërimi është mjeti më i mirë për rrënjosjen e moralit. Përsosmëria e Tij më e madhe është se ashtu siç na largon nga nevojat e stomakut, na pastron edhe nga zilia e shqisave; syri, veshi, gjuha, zemra apo mendimet e liga të imagjinatës. Domethënë secilës shqisë i ndalohet të ndërhyjë në shijime të ndaluara dhe të padobishme. Për shembull, syrin e ndalon nga vështrimi i haramëve dhe nga lëvizjet në vende të dyshimta, kurse veshin e drejton të mos dëgjojë fjalët e liga, por Kur’anin dhe fjalët e drejta. Në këtë mënyrë edhe shqisat e tjera i shtyn të agjërojnë në këtë muaj të ndritur.

Islami i shikon interesat e shoqërisë mbi interesat e individit. Shërbimi ndaj Zotit bëhet nëpërmjet një jete të pastër në shumëllojshmërinë e shoqërisë. Zoti ka krijuar njerëzit me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale dhe shpirtërore. Ai na ka bërë të gjithëve ne të kemi nevojë për njëri-tjetrin për përfitime të dyanshme. Nga kjo, nënkuptohet që Ramazani dhe respektivisht agjërimi ka rëndësi sociale, se secili person kërkon me veprimet e tij të dalë në dritë e gjithë shoqëria Islame, duke u bërë kështu të devotshëm, të mirëorganizuar dhe të mirëdisiplinuar. Pra, kjo shoqëri myslimane në këtë muaj, jeton dhe punon sipas kodit hyjnor moral të shkruar në Kur’anin e shenjtë që ka zbritur në këtë muaj.

Falë agjëritit të Ramazanit, në jetën shoqërore njeriu krijon lidhje të ndryshme me njerëzit e tjerë. Me këtë, ai ndjen një lidhje të fuqishme ndaj tyre. Bashkë me të gjithë besimtarët, fillimi i agjëritit në të njëjtin çast, pritja e iftarit, ngritja në syfy, falja e teravive me xhemat, gdhirja e natës së kadrit, hyrja në bajram etj., bëhen shkak për një vëllazëri shumë të shëndoshë dhe për një dashuri të vërtetë. Kështu, besimtarët bëhen si gjymtyrët e një trupi të vetëm, ashtu siç shprehet edhe Profeti ynë: “Në dashurinë për njëri tjetrin, në dhimbjen për njëri-tjetrin dhe në dhembshurinë për njëri-tjetrin, besimtarët janë si një trup i vetëm. Po qe se një organ ankohet, organet e tjera rrinë pa gjumë e rënkojnë”

Përgatit: Enea Muhameti



VËLLAZËRIA, si themel i paqes



Janë parë në një këndvështrim interesant tri evente të Selisë së Shenjtë Bektashiane nga komuniteti i besimtarëve në Maqedoninë Veriore. Është përkujtuar Gjergj Kastriot Skënderbeu në vitin jubilar të tij, duke sjellë në vëmendje çerek shekullin e lavdishëm të lirisë në natën e gjatë otomane, por edhe rolin e tij në bashkimin e principatave të Ilirisë. Është bërë me dije opinion i gjerë në Shkup, lidhur me vendimin e Gjykatës së Strasburgut, i cili u rikthen të drejtat e mohuara besimtarëve të teqesë “Harabati-Baba” të Tetovës, si edhe është festuar midis miqsh të shumtë ditëlindja e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Të tri këto evente, përmes konferencës të shtypit, të pranisë së Madhërisë së saj Princesha Maria Amor, Hirësisë së Tij Jordan Plevnes, Shkëlqesisë së Tij, z. Fatmir Sejdiu, të akademikut Ali Aliut, si edhe përfaqësues të lartë të trupit diplomatik në Shkup, rritën shkallën e interesit, duke u shndërruar

në një ngjarje mbresëlënëse dhe duke zgjuar emocione të veçanta në 14 majin e sivjetshëm.

Në konferencën për shtyp, në Institutin e Trashëgimisë Shqiptare në Shkup, ishte z. Skënder Hasani, i cili kumtoi për vlerat e besimit bektashian, duke u ndalur sidomos në traditat më të vyera të tij. Nga ana e tij edhe z. Sulejmani solli përvojën në bashkëpunimin fetar të teqesë “Harabati-Baba”. Ndërsa Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u ndal veçanërisht në rrugëtimin shpirtëror të tarikatit që udhëheq, duke sjellë shembuj të shumtë të tolerancës fetare të shpalosur në kohëra dhe vende të ndryshme. Në fund të fjalës së tij, Kryegjyshi tha se viset ku jemi sot, kanë dëshmuar se besimi i vyer bektashian, është përqaftuar nga mijëra e mijëra besimtarë nëpër shekuj, sepse veç devocionit të palëkundur në Zot, kanë mbledhur e vëllazëruar etni, raca e popuj të ndryshëm. Në themel të bektashizmit ka qenë dhe mbetet ideja e lirisë universale,



brenda frymës së Haxhi Bektash Veliut, të dymbëdhjetë imamëve, të dervishëve dhe baballarëve të urtë. Teqeja e "Harabati Babës" së Tetovës, është shembulli më i shkëlqyer se si një tarikat i Islamit, gjeneron paqe e mirësi duke shumëfishuar vlerat e fesë sonë muhamedane.

Ne, si bij shpirtëror të dervishëve dhe baballarëve bektashianë, jemi përpjekur që jo vetëm me njeri-tjetrin, por edhe me vëllezërit e feve të tjera, edhe me strukturat e ndryshëm shtetërorë, të zgjidhen çdo problem përmes arsytimit të ftohtë dhe tolerancës. Çdo gjë ka vajtur mirë kur na kanë kuptuar. E kundërta ka ndodhur kur na kanë keqkuptuar. Shembulli i vendimit të ditëve të fundit, të dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Strasburgut është domethënëse. Sidoqoftë, ne kemi qenë dhe do të mbetemi shembulli më i mirë i rrezatimit të urtësisë dhe mirësisë, sikundër mbetemi në rreshtat e parë të barrikadës ndaj çdo lloj ekstremizmi fetar apo politizim të Islamit. Kemi ardhur në këtë botë të shpërndajmë vëllazëri dhe të tillë do mbetemi.

Paskëtaj, në Qendrën e Unionit Evropian, u bisedua rreth problematikave të sotme në kontekst të marrëdhënieve ndërfaqetare. Sollën aty

përvojat e tyre zotërinjtë Sereqi dhe Sulejmani, për t'ia lënë vendin më pas Kryegjyshit Botëror Bektashian. Ky, pasi falënderoi të pranishmit, e quajti këtë ditë me ngarkesë të veçantë emocionale, sepse të tilla ishin sidomos kontributi i Gjergj Kastriot Skënderbeut në historinë tonë kombëtare, si edhe vendimi i dhënë në Strasburg. Ai tha midis të tjerave se "Veprimtaria e sotme në lidhje me tolerancën fetare si edhe vendimin e këtyre ditëve të Gjykatës së Strasburgut, përmes të cilit neve bektashinjtë na jepet një drejtë e mohuar, është padyshim një ngjarje që le gjurmë. Duke pasur besim të palëkundur tek Zoti i Madh, por edhe tek segment të caktuar të mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare, ne gjithmonë besuam tek e vërteta e shenjtë. Tek e vërteta e një tarikati që ndonëse i lindur 800 vite më parë, ende sot po rritet e zhvillohet duke pushtuar territore të rinj shpirtërorë.

Rrjedhat e historisë botërore, herë të qeta dhe herë të vrullshme e plot rreziqe të mënxyrëshëm, besoj se na kanë ofruar të gjithëve, mësimin e vyer se vlen një orë e më parë, të bashkohemi në vëllazërinë e madhe, jo vetëm të mirëkuptimit, por edhe të pranimit me gjithë zemër të

karakterit të ndjeshëm, moralit dhe orientimit fetar të njeriut që kemi në krahë, pavarësisht se ndryshojmë në racë, ngjyrë dhe etni. Unë besoj se të gjithë ne, ndajmë mendimi se karakteret, gjuhët që flasim, orientimet fetare, traditat kulturore, do të jenë të shumëllojshme dhe në kundërshti, derisa të ekzistojë kjo botë. Por pavarësisht këtij diversiteti, ne kemi qenë, jemi dhe do të mbetemi krijesa të të njëjtit Zot. Duke iu referuar një Ati të përbashkët, në të vërtetë ne i afrohem qoftë në përpjekje, qoftë në vizion, një bote në paqe. Besimi që unë përfaqësoj sot, ka një histori jo më shumë se 800 vjet. Si një tarikat i Islamit, bektashizmi është një lloj sistemi doktrinor dhe shpirtëror që u flet zemrës dhe ndërgjegjes së besimtarit, me synimin për ta lehtësuar atë prej peshës së gjërave të vdekshme dhe për ta afruar sa më shumë ndaj vëmendjes së krijuesit. Jo vetëm simbolikisht, por sidomos në esencë të bektashizmit është vëllazëria si një themel i qëndrueshëm i shtëpisë së paqes. Veprimtaria e sotme sigurisht më jep rastin e lumë t'u kujtoj të gjithëve se heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu, me jetën dhe veprën e vet të pavdekshme ka ndriçuar kurdoherë shpirtat e besimtarëve bektashianë, duke u falur atyre idenë e unitetit të përjetshëm "At-dhe dhe Fe" Unë mendoj evokimi i jubileut të heroit tonë kombëtar, nuk është thjeshtë një kujtesë, por thirrje për të trokitur kryelartë në dyert e sotme të Evropës. Ndërkaq përkujtimi i ditëlindjes sime, më jep emocionin e madh dhe duke ju falenderuar sinqerisht, them se nuk do të lodhem asnjëherë duke punuar për të ngritur në lartësinë që kërkon përgjegjësia historike, Selinë e Shenjtë Bektashiane".

Të pranishmit ndoqën gjithashtu në këtë event bisedën të realizuar

elektronikisht me avokatin që mbrojt çështjen bektashiane në Strasburg z. Aleksandër Goxha.

Ndërsa mbrëmja mblodhi në mjesditet e teqesë "Harabati-Baba" të gjithë të ftuarit që patën kontribuar sidomos në lidhje me të drejtat e fituara tashmë të besimtarëve të teqesë. Ambasadori i SHBA në Shkup, Shkëlqesia e Tij Jess Baily, në përshëndetjen e tij u ndal sidomos në kontributin e bektashizmit për tolerancën fetare në Ballkan. Fjalë të ngrohta tha edhe Madhëria e saj, Princesha Maria Amor, e cila mbeti e mrekulluar nga mikpritja dhe traditat bektashiane. Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj shtoi midis të tjerave: "Ju falënderoj sinqerisht që jeni sot të pranishëm për të ndarë së bashku emocionet e mrekullueshme të kësaj dite. Është një jubile i lavdishëmi i heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, i cili jo vetëm na fal krenarinë e ligjshme të të qenit shqiptarë, por edhe na kujton ne dhe të tjerëve, se aspirata e gjysh-stërgjyshëve tanë ka qënë Evropa. Shekujt e gjatë të robërisë nuk tjetërsuan dot këtë shpresë tonën, ndaj pavarësisht post-komunizmit shqiptar, jemi të ndërgjegjshëm se shumë shpejt do t'i bashkohemi familjes tonë

historike. Vendimin e dhënë këto ditë nga gjykata ndërkombëtare e Strazburgut, do të shohim jo si një "fitore ndaj kundërshtarit", por si një e drejtë e vonuar, e cila sigurisht do t'i shërbejë jo vetëm harmonisë dhe tolerancës fetare në Maqedoni, por edhe zhvillimeve të saj në udhën e pakthyeshme drejt vlerave të qytetërimit Evropian.

Selia e Shenjtë Bektashiane në Tiranë mban mbi supë një histori më shumë se 800 vjeçare, fillimet e së cilës kanë nisur në teqenë e parë bektashiane, në Nevshahirin e sotëm të Turqisë. Por krejt kjo histori ka treguar se pavarësisht rrethanave historike, pavarësisht luftërave dhe ngatërimeve, qëndrimet dhe prirjet tona kanë mundur të ngrihen mbi interesat dhe lëvizjet sektare, duke mbrojtur bashkëjetesën fetare, përmes kodit doktrinor dhe zakonor të tyre. Ne kemi konsideruar kurdoherë se ka qënë vullneti i Zotit që të jetojmë mes identiteteve të ndryshëm, sigurisht në një qiell e tokë të përbashkët, dhe brenda kësaj hijeshie të stolitur me dorën e Krijuesit, bektashinjtë kanë vënë mendjen, zemrën dhe sakrificat e pafund, drejt aktit të vëllazërisë fetare.

Ju siguroj të nderuar të pranishëm, se këtë filozofi të mrekullueshme do ta vazhdojmë ta përcjellim brez

pas brezi. Së fundi, dua të them se çdo lloj bashkëjetese midis feve në Ballkan dhe më gjerë, pavarësisht stadeve të arritura, shqetësimeve apo prirjeve të shfaqura, vlen të shihet jo si dëshmi muzeale, por si një realitet i dhe destinuar të përparojë me vullnetin e të gjithëve ne që i falemi një Zoti të vetëm. Ndryshe, po e pamë besimin dhe tolerancën sipas këndvështrimit në llogoret tona, atëherë ai bëhet kërcënues dhe na mbanë larg ëndrrës europiane.

Aktet barbare të këtyre kohëve, të nxitura nga politizimi i Islamit dhe ekstremizmave të tjerë, janë arsye më shumë për t'u bashkuar, për të unifikuar betejën tonë njerëzore sipas modeleve më të mira të zbritura në tokë prej Krijuesit.

Falënderoj ndërkaq së bashku me ju, edhe krejt ata lider fetar dhe politik në Maqedoni që gjetëm kohën për të më uruar ditëlindjen time dhe lus Zotin të më jap forca dhe energji për të vijuar më tej, detyrimet e mëdha të Selisë sonë të Shenjtë, ndaj komuniteteve bektashiane të kudondodhur në botë. Zoti ju bekoftë të gjithëve! Amin!"

Në sofrën e shtruar, në teqenë "Harabati-Baba", bisedat, përshëndetjet, këngët vijuan gjatë.

Koresp "Urtësia"



SHQIPËRIA, model i harmonisë fetare

*Krerët e besimeve nënshkruajnë marrëveshjen
e bashkëpunimit*

Nga Kujtim BORIÇI

Në datën 3 maj 2018, në mjediset e Hotel Rogner International, në Tiranë, u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare për dialogun midis besimeve: “Shqipëria, një model i harmonisë ndërfaqetare për Evropën”. Organizatorët e saj, me mbështetjen e Ambasadës së Austrisë në vendin tonë, ishin Universiteti “Beder”, Kolegji Universitar “Logos” dhe Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Në të morën pjesë kryetarët e Komuniteteve Fetare, klerikë, përfaqësues shtetërorë, akademikë, kërkues e teologë nga Shqipëria dhe Evropa etj.

Seanca e parë e Konferencës, që u moderua nga Kryetarja e Komitetit për Kultet, znj. Loreta Aliko, u hap nga Ambasadori i Austrisë, z. Johann Saçler dhe më pas përshëndetën Nunci Apostolik në Shqipëri, Mons. Charles Broën dhe Ministrija e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro.

Në vazhdim e morën fjalën kryetarët e Komuniteteve Fetare, duke nisur nga Kryetari i Komunitetit Mysliman, Hirësia e Tij, Skënder Bruçaj dhe Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlurturia e Tij Anastasi, i cili tha se “Gjatë këtyre viteve u përpoqëm të kultivonim respektin e ndërsjellë, reciprocitetin dhe bashkëjetesën harmonike reciproke”...



Duke theksuar më tej se “Ne përpiqemi të marrim lëngjet nga rrënjët e shëndetshme të biomës fetare dhe të ndihmojmë në zhvillimin social dhe përparimin e Shqipërisë...”.

Më pas folën Kryegjyshi Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj dhe Presidenti i Vëllazërisë Ungjillore, z.Ylli Doçi. Në fund, kryetarët e Komuniteteve Fetare nënshkruan një deklaratë të përbashkët. Më pas u vazhdua me sesionet e veprimtarisë, ku folën pedagogë nga të tria universitetet, teologë, studiues të huaj etj.

..Në fjalën përshëndetëse, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj theksoi: “Është nder dhe kënaqësi e veçantë të marr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare rreth dialogut ndërfetar deh t’ju përshëndes në emër të miliona besimtarëve bektashinj të kudondodhur në botë: Zoti e pastë në vëmendje devocionin Tuaj dhe sjellte paqe e begati për gjithë njerëzimin! Vendi im, Shqipëria, ndonëse ka jetuar ngjarje të frikshme në këta 25 vite të post-komunizmit, ndonëse për kancelari të ndryshme është parë si tokë me sizmikë shpërthyes, sigurisht ka diçka të bukur brenda vetes. Ka margaritarin e çmuar të modelit të harmonisë dhe bashkëjetesës fetare. A është ky vullnet i Zotit? Sigurisht që po.

Por, nëse Zoti i madhëruar na ka falur këtë mrekulli, ne sigurisht i falemi Atij për çdo mirësi në këtë botë dhe në tjetrën, duke mos harruar se jemi vëllezër me një të shkuar, të sotme dhe të ardhme të përbashkët. Ashtu sikundër në një familje biologjike, ku mbizotëron harmonia dhe respekti i ndërsjelltë, trashëgohen vlerat e përkryera morale edhe në familjen e madhe të një kombi, këto vlera sigurisht që na nxjerrin në dritë.

Besimi bektashian të cilin unë përfaqësoj, i përmbahet qysh në themel të tij e deri më sot, njërit prej mësimëve të vyer të themeluesit tonë, Haxhi Bektash Veliut, i cili 800 vite më parë ka shkruar: “Kurani i Madhëruar është besimi ynë dhe Muhamed Mustafai ndërmjetësi. Ademi dhe Havaja janë babai dhe nëna jonë. Ne të gjithë jemi vëllezër të njeri-tjetrit. Të gjitha mrekullitë janë krijuar për ne, nga lartësitë e epërme të qiellit deri tek fundi i dheut.

“Nisur nga kjo, teqetë bektashiane, në esencë të filozofisë së tyre kanë përcjellë pikërisht idenë e të qenit vëllezër, pavarësisht etnisë, racës, gjuhës, apo kujt feje i jemi përkushtuar. Nuk është e rastit që shumë studiues europianë, duke e parë bektashizmin si urë lidhëse midis feve dhe etnive, kanë shkruar qindra faqe ngazëllyese për këtë tarikat të shquar të Islamit, i cili ka ndikuar fuqishëm në kontekstin fetar ballkanik. Ndërsa shembulli i harmonisë dhe paqes fetare në Shqipëri, padyshim është emblemantik. Myslimanët shqiptarë syni dhe bektashi, janë bashkuar me vëllezërit e tyre të krishterë në çdo lëvizje anti-osmane, për pavarësinë dhe prosperitetin e trojeve tanë. E njëjta situatë na ka bashkuar me të krishterët shqiptarë, kur jugu i vendit pushtohej prej grekëve apo veriu prej serbëve, për t’u finalizuar në lëvizjen e madhe kombëtare të Luftës së Dytë Botërore.

Ne lider fetarë dhe besimtarë të zakonshëm, duke adhuruar me devocion Krijuesin, duke ruajtur dhe respektuar traditat fetare dhe atdhetare, sidomos në vitet e inkuizicionit antifetar komunist 1967-1990, i rrëfyem Europës së qytetëruar, se pavarësisht stuhive të çfarëdollojshme, dashuria për Zotin, për njeri-tjetrin, mirëkuptimi dhe solidariteti fetar, mbeten si një xhevahir i mrekullueshëm në gjerdan të identitetit

tonë. Është kjo arsyeja, të nderuar të pranishëm, që Papa Françesku, në vizitën e tij në Shqipëri në vitin 2014, shkoi shumë larg në lidhje me konceptin e harmonisë fetare, duke thënë se, “tek ju ekziston vëllezëria fetare”. Ky vlerësim i madh për një komb të vogël, mbetet padyshim një nder i veçantë, po ashtu dhe detyrim për të ruajtur e zhvilluar më tej vëllazërinë fetare, për ta ruajtur atë nga çdo ekstremizëm i kohës.

Sepse pa dyshim, ky rrap degëgjërë dhe madhështorë i vëllazërisë sonë fetare, duhet parë me kujdesin më të madh, duke shmangur çdo lloj prirjeje ekstremiste fetare, pavarësisht nga cila epokë, apo cili vend vjen. Ruajtja e identitetit tonë fetar, na jep të drejtën të trokasim krejlartë në dyer e familjes europiane”

Në vazhdim, krerët e komuniteteve fetarë, përkatësisht H. Skender Brucaj i Komuniteti

Mysliman i Shqipërisë, Fortlumburi Anastas Janullatos nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Mons. George Frenco i Konferenca Ipeshkvnore Katolike e Shqipërisë Kisha Katolike, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Pastor Ylli Doçi nga Vllazëria Ungjillore e Shqipërisë nënshkruan deklaratën e bashkëpunimit.

DEKLARATA E BASHKËPUNIMIT

“Ne, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike e Shqipërisë, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë falenderojmë Zotin për historinë e bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfitare në Shqipëri ndër shekuj. Mirëkuptimi dhe bashkëjetesa fetare brenda vendit tonë ka krijuar ndër vite një mozaik të bukur të diversitetit. Ne jemi të bindur se ky mozaik nuk duhet konsideruar i mirëqenë dhe angazhohemi të kujdesemi për të, duke mbajtur të bashkuar pjesët e tij, me qëllim që të ruajmë dhe të prezantojmë me dinjitet këtë pasuri brenda dhe jashtë vendit.

Ne jemi të vetëdijshëm dhe pranojmë se komunitetet tona fetare, kanë identitetin e tyre dhe se secili mbetet besnik ndaj parimeve të besimit të tij. Por megjithatë dallimet tona fetare nuk na pengojnë për t’u angazhuar në respektin e ndërsjellë, bashkëpunimin në fushat sociale dhe në dialogun aktiv midis komuniteteve tona dhe mbarë shoqërisë me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave morale, etike dhe kulturore. Ne vlerësojmë komunikimin, si mjet për t’u njohur më nga afër me njëri-tjetrin, për ndërtimin e respektit të ndërsjelltë, si dhe për shmangien e paragjyqimeve. Për këtë arsye ne angazhohemi për sa më poshtë:

Të zhvillojmë dialogun e jetës, duke inkurajuar anëtarët e komuniteteve tona, por edhe shoqërinë në përgjithësi të jetojnë në paqe dhe në fqinjësi të mirë, duke ndarë gëzimin dhe trishtimin, sfidat dhe shpresat me njëri-tjetrin.

Të zhvillojmë veprimtari të përbashkëta për të mirën e shoqërisë, duke u angazhuar në iniciativa, sipërmarrje dhe projekte për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe nëpërmjet këtyre angazhimeve në të njëjtën kohë të ushqejmë harmoninë, tolerancën, bashkëjetesën, drejtësinë dhe paqen në komunitetet tona.

Të ndërtojmë platformën e dialogut në nivel akademik, duke u njohur me vlerat shpirtërore të njëri-tjetrit, historinë e ndërsjellë dhe pikat e përbashkëta, me qëllim promovimin e frymës së dialogut dhe asaj vëllazërore brenda komuniteteve tona, duke shmangur çdo gjë, që mund të nxisë urrejtje dhe keqkuptime ndërfitare.

Të zhvillojmë strategji të përbashkëta arsimore dhe edukative për të promovuar dhe ushqyer brezin e ri me vlerat e bashkëjetesës dhe dialogut ndërfitar, për të parandaluar çdo formë manipulimi dhe instrumentalizimi të fesë në shërbim të interesave jofetare.

Të promovojmë në arenën ndërkombëtare, me të gjitha mënyrat, vlerën e bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfitare në Shqipëri, si një shembull i dobishëm për mbarë shoqërinë botërore, e cila në mënyrë të vazhdueshme përballet me sfidat e intolerancës dhe formave të ndryshme të konflikteve.

Me dëshirën tonë të mirë dhe shpresën, që Zoti do të na japë energjinë dhe qëndrueshmërinë për të vazhduar në rrugën tonë të bashkëjetesës, harmonisë, tolerancës dhe dialogut, ne përfaqësuesit e komuniteteve fetare shqiptare nënshkruajmë sot (03.05.2018) deklaratën e mësipërme.”

Ky vend i bekuar



Nga Nuri Çuni

Ashtu herët duke udhëtuar drejt teqesë së Alipostivanit në ditën e pelegrinazhit të përvitshëm tashmë një traditë e vyer, vijnë pelegrinët nga Përmeti, Skrapari, Gjirokastra, Tepelena, Vlora, Fieri, Mallakstra, Berati, Lushnja, Durrësi, Tirana dhe Elbasani. Sapo kalon kthesën e Piskovës së Përmetit, drejt teqesë së baba Aliut në fshatin Alipostivan, makinat në varg njeri pas tjetrit ngjiten në udhën gjarpërushe të pllajës drejt teqesë. Duke udhëtuar, të bie në sy rregulli i ngjitjes dhe zbritjeve të makinave në radhë, falë punës korekte që kërkojnë dhe zbatojnë policia rrugore e Përmetit. Ata me buzëqeshje dhe mirësjelle përshëndesin dhe urojnë për këtë festë të bekuar. Asnjë pengesë, asnjë zë i

lartë, asnjë aksident në këtë mori të madhe makinash dhe pelegrinësh në 14 majin pranveror. Sapo hymë në portën e madhe të hyrjes së teqesë duke kaluar pranë bustit monumental të themeluesit të tarikatit bektashian, Haxhi Bektash Veliut me dorën e ngritur, sikur të përshëndet, e të thotë mirëse erdhët në vendin e shenjtë.

Këtu ka herët, në këtë pikë nyje, ka qënë udhë kalimi për në Përmet, Këlcyrë, Frashër, Skrapar, siç thonë studiuesit ka qënë rruga e vjetër me kalldrëm ndoshta të periudhës romake. Fakti që duke punuar në zgjerimin e teqesë dhe ndërtimin e tyrbeve të reja në këtë vend thotë baba Hekurani, u gjenden tubacione qeramike të ujësjellësit, si dhe një gurë shtufi me përmasa të vogla, është një stelë bazoreliev me qeparisë dhe sibole të veçanta, (Babai i ruan me



kujdes për ti vendosur në muzeun e ardhshëm të teqesë) Stela të jep iden e një vendi të shenjtë qysh në iliri. Sigurisht kjo kërkon gërmime dhe studime të mëtejshme në mjediset rreth teqesë, për të dhënë mendim të plotë të këtij vendi të hershëm arkeologjik.

Këtu në këtë vend kodër piktoresk, që shikon luginën e Vjosës deri në horizont me majën e Nemërçkës dhe deri tej në malet matan kufirit, në Greqi. Punimet shumë vjeçare të mjedisit të mrekullueshëm nën drejtimin dhe organizimin e baba Hekuranit e ka kthyer në një oazë bukurie, ndërtime, mjedise të plotë, rrethuar me vreshta rrushi, frutorë të tjerë: qershi, mollë, dardhë, kumbulla, ftonjë e rrethuar nga lisat e gjatë të malit në vazhdim të fshatit Seničan, vendlindja e baba Hekuranit. Punimet e këtij viti e pasuroi dhe zbukuroi më shumë mjedisin e teqesë së Alipostivanit. Në kodrën zotëruese janë bërë punime të një depo uji që mer deri 800 metro kub, që furnizohet nga dy puse të mëdhenjë me pompë, banja të rregullta në sheshin e madh të pelegrineve dhe poshtë saj 15 të tilla. Lulet shumëngjyrshë, trëndafilat dhe lule të tjera, si gjithë mjedisi rrethues e bëjnë teqenë edhe më magjik, e ndjen ndijesin e qetësisë e aromës dhe duke ecur në gjithë teritorin e teqesë, të mer

gëzimi dhe shpresa, se je në një vend të shenjtë me histori të madhe për të mësuar dhe besuar se këtu vjen dhe lartëson shpirtin në adhurim të Krijuesit. Siç thuhet në Kuranin Qerim: “Kush bën një punë të mirë, mashkull ose femër qoftë dhe është besimtar. Ne do ti japim atij një jetë të mirë... (Sure “En Nahl, ajeti 97) Sepse duke adhuruar dhe vjen në pelegrinazh te vendi i shenjtë kërkues i lutjes që nuk është kontraditë, por lutja është shkak dhe lidhës i vazhdueshëm për realizimin me sukses të punëve. Sepse vetë Allahu thotë kur kini hallë dhe nevojë ndrejtohuni vendeve të shenjta. Siç thonë imamët e nderuar se në kontekstin e gjërë, lutja është një fushë e madhe, është një fond kolosal është shkollë për të studiuar dhe mësuar sepse ka fushë edukimi dhe mësimi. Në fund lutja është një dëshirë e zjarrtë për të zotëruar virtytet më të mira e për të hequr dorë nga punët e liga. Kjo e bënë që pelegrinët e shumta të ardhur nga shumë krahina të Shqipërisë e bënë këtë peligrinazh në Alipostivën një Tomor i vogël. Pret e përcjell baba Hekurani gjithë pelegrinët në dashurinë e mirësin e paqes dhe dashurisë, duke dhënë ngrohtësi e urtësi që sejcili ndjen dhe gëzon se teqetë bektashiane janë prehtore dhe mësonjtore të çdo njeriu pavarsisht nga besimi dhe etnia, sepse ndjen dashurinë e madhe ndaj Zotit. Këtë dashuri e gjen tek baballarët e dervishët bektashianë në këta tetë shekujt që Haxhi Bektash Veliu formësoi dhe dha dritën bektashianë që edhe sot ndriçon e jep dritë për të ecur në rrugën e pagabuar të tarikatit bektashian. Në fjalën e rastit baba Hekurani: falenderoi pjesëmarrsit, besimtarët, klerikët: baba Sadiku, baba Abdyli, dervish Sali Peti, dervish Mikeli, të ardhur nga teqe të tjera të Shqipërisë, intelektual, deputet dhe përfaqësues të pushtetit vendor të Përmetit dhe Këlcyrës, përfaqësuesit e Kryegjyshit Botëror Bektashianë me idenë, se teqeja e Alipostivanit do të punojë dhe rritë më shumë detyrat e saj ndaj besimit bektashian dhe afruar dhe nxitur tek të gjithë punët e mira në çdo rast për lartësimin e shpirtit dhe moralin e lartë në dashuri ndaj Zotit dhe atdheut. Informoi pjesëmarrsit për vendimin e drejt të gjykatës të Strasburgut për njohjen e të drejtave që duhet të ushtroj në Maqedoni komuniteti bektashian si gjithë besimet e tjera u durtrokit nga të gjithë.” U dha mesazhi i Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve të Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj: “Është kënaqësi e veçantë për mua, t’ju përshëndes

në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian dhe t'ju uroj nga zemra: Paçi fat e mbarësi kurdoherë në shtëpitë tuaja! Zoti qoftë i kënaqur me devocionin tuaj! Teqeja e Alipostivanit në Përmet, padyshim ka vendin dhe rolin e vet në krejt bektashizmin e Shqipërisë Jugore. Kjo teqe, dikur çerdhe e veprimtarive të shquara për dije dhe arësim, në vitet e mëpastajmë rrëfen traditat më të vyera bektashiane. Ajo ishte dhe mbetet sidomos sot, vatra ku vijnë dhe gjejnë shpresë e shërim shpirtëror, besimtarë të shumtë jo vetëm nga Përmeti e Frashëri, por edhe Gjirokastra, Skrapari, Vlora, Tepelena e Kolonja. Qysh nga krijimi i saj gati dy shekuj më parë në këtë teqe kanë shërbyer të ndritur dervishësh dhe baballarësh bektashianë, të cilët nuk e ndanë asnjëherë dashurinë për Zotin nga dashuria për Kombën.

Këta klerikë të shquar do të mbeten në kujtesën tonë, jo vetëm për atë çka u përcollën brezave, por edhe për ruajtjen dhe pasurimin e traditave të mrekullueshme të bektashizmit. Në këto gjurmë, po ecën sot padyshim edhe vëllai im dhe i juaji, baba Hekurani, të cilin gjej rastin ta falenderoj për ringritjen nga hiç të kësaj teqeje, duke e shndërruar vendin e shkretë të dikurshëm në një vend të bekuar.

Unë jam i sigurtë se me vrullin dhe energjinë e tij, baba Hekurani do të vazhdojë të kontribuojë dita ditës, jo vetëm në ringritjen e objekteve të kultit, por në mënyrë të veçantë në përhapjen e frymës të vëllazërisë dhe shpresës. Gëzuar ditën e 14 Majit!”

Kurse historiani Kastriot Bezati dha një panoramë të shkurtër historik të themelimit të teqesë Alipostivanit, duke u ndalur, tek baba Ali Horasni, i cili hodhi rrënjët e misjonarit të parë në këtë vend, duke mbjellë mirësi dhe dashuri, harmoni në banorët, jo vetëm të fshatit Alipostivan, por edhe në rrethinat e saj, qysh në shekullin e XVI. Foli për lavdinë e teqesë së Frashërit, Përmetit Sukës, Këlcyrës, ku teqetë ishin vatra të mësimin të gjuhës shqipe në rilidjen kombëtare. Në këtë teqe që gjithë baballarët dhe dervishët lanë gjurmët dhe shkruan një histori të mrekullueshme.

Grupi folklorik “Çipini” me këngët tërë kolorit të bektashizmit dhe humoristik i dhanë gjallëri dhe gëzim drekës së shtruar enkas me këtë rast. Me kënaqësinë e veçant çdo pelegrin u largua nga Alipostivani jo vetëm me dashurinë e vendit të shenjtë por edhe me gëzimin dhe shpresën e një të ardhme më të mirë.



Vizatim nga



nga Nuri Çuni

Siç është pranvera, nga më të bukurat e stinës, mozaiku shumëngjyrës të tërheq dhe këtë e ndjen në mëngjezin e veçantë, sapo futesh në mjedisin e mrekullueshëm të Bredhit të Hotovës. Këtu ndjen ajrin magjik, aromën e luleve të shumta, shikon burimin në anë të rrugës, ku ka pirë ujë Naimi. Ashtu me mendjen e kthjelltë arrin në fshat, tek shtëpia muze e vëllezërve Frashëri. Por, në këtë bukuri të natyrës mrekulli. Trishtohesh tek shikon braktisjen e madhe të Frashërit, pa njerëz, pa rrugë, pa shkollë, Kurse atje, në rrëzë të Kokojkës teqeja e famshme monument historie dhe kulture. Gradualisht vijmë nga Përmeti, Tepelena dhe Gjirokastra, Durrësi

dhe Tiranë dhe nxënësit e shkollës së mesme të Rahovecit nga Kosova. Vijnë shkrimtarë dhe poetë, studiues, shkenctarë dhe nga shoqata atdhetare kulturore, "Vëllezërit Frashëri", "Përmeti", Dangallia", "Tomori", "Zëri Dardan". Mer pjesë Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryetari Bashkisë Përmetit z. Niko Shupuli, kryetari i Komunës Rahovec z. Smajl Latifi, Prof. dr. Hajri Haska, poetja Diana Çuli dhe poetë nga Shqipëria dhe Kosova. Kjo veprimtari bëhet në kuadrin e vitit të Skenderbeut dhe 172 vjetorin e lindjes së Naim Frashërit. Kjo ditë e shënuar është ideuar dhe konceptuar nga organizatorët nën drejtimin e Kryetarit të Shoqatës "Vëllezërit Frashëri", z. Tomor Kotorri, që tashëm ka një traditë nga viti

Frashëri

2004 dhe deri më sot, me temën: “Naim Frasheri edukator i madh i kombit”.

Natyrshëm organizatorët ftuan pjesëmarrsit në vizitën e muzeut të vëllezërve Frashëri, ku historiani Kastriot Bezati përcolli mesazhin e vëllezërve Frashëri. “Të duam Shqipërinë”, në stendat dhe dokumentat arkivore, objektet dhe relike të ndryshme muzeale ngjallin interesin e pjesmarrësve në këtë muze. Më pas me hymnin kombëtar para busteve të vëllezërve Frashëri, fillon ceremoniali me fjalën e mirëseardhjes të z. Tomor Kotori: “Është një nder dhe kënaqesi e veçant për mua, që në cilësinë e kryetarit të shoqatës t’ju falenderoj dhe t’ju uroj mirëseardhjen në Frashërin e historisë dhe të kulturës, në vendlindjen e vëllezërve Frashëri, mirëserdhët në teqenë e baba Nasibit dhe baba Alushit, në këtë teqe historike, mirë serdhët në Mekën e Shqipërisë”.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve u shpreh: “Këtu në Frashër u bë historia e madhe dhe luajtën një rol të padiskutueshëm baballërt e teqesë, nga baba Nasibiu, baba Alushi dhe baba Abedini e me radhë. Kjo rrezatoi jo vetëm në jugun e Shqipërisë por edhe më gjërë. E meriton Frashëri të shikohet me një sy të thelluar, për tu gjallëruar jo vetëm në ifrastruktura por në gjithë përfshirjen histor-

ike-kulturore-fetare-turistike, ta ruajmë zërin dhe vatrën e Frashërit nga harrimi dhe braktisja. Prandaj duhet sensibilizuar më shumë se kurrë, tërë institucionet shtetërore, tërë forcat akademike e intelektuale, kudo që janë, që të vlerësojnë këtë thirrje të kohës, se Frashëri po braktiset plotësisht. Ta ringjallim sa më parë. Dita naimiane dhe kultura bektashiane tashmë ka vitin e tretë që po bëhet traditë në organizimin nga Kryegjyshata Botërore Bekashaine, në Parisë të Francës dhe po jep vlerat e veçanta të bektashizmit botërorë”. Më pas morën fjalën kryetari i Bashkisë Përmetit z. Niko Shupuli, kryetari i komunës Rahovecit z. Smajl Latifi, i cili midis të tjerave falenderoi organizatorët e kësaj veprimtarie të përvitshme

që ne po marrim pjesë këto vitet e fundit duke u bërë pjesë e kësaj dite madhore dhe na bashkon qëllimi i përbashkët i mbajtjes gjallë të këtyre vlerave të mëdha të vëllezërve Frashëri, që e rilindën kombin tonë i dhanë veçantitë kombëtare. Këtu në Frashër, u hodhën idetë dhe projektet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga baba Alushi i famshëm dhe Abdyl Frashëri, që ky vit është edhe 140 vjetori i saj dhe do festohet në Prizren. Qofshim gjithmonë të bashkuar.” Ndërsa Kryetari i Bashkisë së Përmetit z. Niko Shupuli midis të tjerave tha: “Frashëri që ka bërë historinë e Shqipërisë e kemi për detyrë të çojmë më tej vlerat e saj të pamohushme, të traditës dhe vlerësimit historik kulturor, fetar, mjedisor për të rikthyer Fra-



shërin në jetën normale dhe jo pa qëllim sot në këtë shtëpi muze do bëjmë mbledhjen e pare të këshillit bashikak se çfarë duhet të bëjmë për Frashërin në vitet e ardhshme, sepse, Frashëri është i të gjithëve dhe duhet të vlerësohet nga të gjithë. Si Bashki do të bëjmë çështje e mundur për të ringjallur Frashërin.”

Me shumë interes u pritën recitimet e poetve shqiptarë nga Përmeti, Gjirokastra Tepelena, Rogozhina, Tirana, krijime për Frashërin dhe poetin e madh Naim Frashëri, koncerti i grupit të nxënësve të shkollës së mesme të Rahovecit-Kosovë, këngë përmetare duke i dhënë një gjallëri kësaj veprimarië të ditës së shënuar. Nxënësit e shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet dhe nxënësit e shkollave Rahovec e Prizeren, sollën atmosferë nga poeteka e Naim Frashërit. Veprimtaria vijoi me “Poeteka” Frashër, ku poetët Petrit Ruka, Agim Xheka, Kozma Billa, Bardhyl Maliqi, Dashamir Malo, Alma Feruni, Xhelal Tosku, Sami Velçani dhe Anila Mihali recituan pjesë nga krijimtaria e tyre përballë Naim Frashërit në këtë ditë të veçantë feste. Këshilli bashkiak i Përmetit organizoi mbledhjen e parë në shtëpinë e lindjes së Vëllezërve Frashëri. I jep titull: “Nderi i Qytetit të Përmetit” studiuesit Bekim Kelmendi midis të tjerave mori një vendim të rëndësishëm: “Frashëri të kthehet në një qender historike-turistike-muzeale”. Kryetari i shoqatës “Vëllezërve Frashëri u ndau Çertifikatë Mirënjohje dhe titullin: “Qytetar Nderi” të shoqatës, për personalitete të ndryshme që kanë kontribuar për Frashërin si: Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj, z. Smajl Latifi dhe Diana Çuli. Veprimtaria vazhdoi me konferencën shkencore me temat e larmishme mbi: shkollat shqipe, ekoturizmi, poema “Qerbelaja”, Naimi në 172 vjetorin e lindjes, pishtarë të lirisë dhe pavarësisë, vendlindja, fletore e bektashinjve. Kokluzionet e konferencës i mbajti Diana Çuli. Kryetari i shoqatës atdhetare kulturore “Vëllezërit Frashëri” z. Tomor Kotorri u lexoi të pranishmëve promemorjen drejtuar institucioneve të larta shtetërore dhe shkencore për të ringjallur Frashërin, e cila u duartroi nga të pranishmit. Më pas u vizitua teqja bektashiane e Frashërit. Kjo ditë solli risi të re si në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak në Frashër dhe promemorjen drejtuar institucioneve të larta shtetërore për ringjalljen e tij. Duke u përmallur me Frashërin historik dhe magjik, secili mori me vete atë se çfarë duhet bërë për të.

Fjala e

Fundi i majit është bërë traditë nga gjyshata e Elbasanit nën drejtimin e baba Faikut dhe dervish Admirat, organizojnë më së miri pelegrinazhin në tyrbën e baba Sakos. Aty të mbledhur besimtarë, dashamirës e të tjerë edhe pse nga ky fshat janë larguar shumë banorë në emigracion, prap vijnë e bëjnë ritet ceremoniale të besimit bektashian. Nëpërmjet antarit të këshillit fetar të këtij fshati z. Hekuran Xhani bëri hapjen e ceremonisë duke falenderuar baba Faikun dhe pjesëmarrsit në këtë ditë të shënuar. Ky i dha fjalën baba Faikut, i cili midis të tjerave tha: “Mesazhi i baba Sakos është edhe sot i fuqishëm me misionin e tij, që erdhi në këtë vend të bekuar ai me mirëkuptimin e banorve të Luzit të Madh, i kuptoi dhe e kuptuan, se besimi bektashian jep veç dashuri, mirësi dhe lutjet te Zoti i Madhëruar për harmoni dhe dashuri gëzon vëllazërinë tek njerëzit. Baba Sakua te populli i Luzit dhe Kavajës la gjurmë të thella, për diturinë dhe mirësinë që mbolli në këtë zonë. Në nderim dhe respekt të tij, kur ai kaloi nga jeta, besimtarët i bënë një tyrbë të bukur pranë teqesë. Kjo teqe vazhdoi traditën e baba Sakos me baballarë dhe dervish të tjerë në vite deri në shkatërrimin e plotë të saj nga shteti monist në vitin famëkeq 1967. Por vetëm mbas vitit 1990 u bë e mundur të rifilloi të rindërtohet tyrbja e baba Sakos. Në këto 27 vjet pelegrinazhi vazhdon dhe e respektojnë gjithë besimtarët dhe dashamirësit e fshatit Luzi i Madh i Kavajës. Me këtë rast dua ti shpreh falenderimet e mija këshillit fetar të fshatit Luzë me drejtues z. Hekuran, të cilët punojnë për të mbajtur gjallë traditën e bukur bektashiane, falenderoj edhe pjesëmarrjen nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane.”

Ceremonia vazhdoi me përshëndetjen e fëmijëve bektashian me këngët e bukura për baba Sakon, Imam Aliun, familjen e Ehli-Bejtit, u mirëprit nga gjithë pjesëmarrsit. Duke bërë pelegrinazh në ditën e shënuar të baba Sakos sejcili ndjen detyrimin e lu-



Ëmbël e Allahut

tjes dhe adhurimit për të. Kjo është edhe të mësosh, të shikosh dhe të dëgjosh. Në takimet dhe bisedat me dervishët dhe baballarët në vite kur këndonin nefese të ndryshme bektashiane, thotë besimtari i vjetër Rakip Ibro, i cili përmend këngën La ilahe illallah një këngë e vjetër e shkruar nga studiuesi turkolog, Haxhi Myzafer Ozak "La ilahe il-lallah":

*Le të them ditë natë
La ilahe il-lallah,
Le ta fshimë ndryshkun nga zemra
La ilahe il-lallah.*

*... Është shërimi i dervishit
Është besimi i besimtarit,
Është prova e të dashuruarit
La ilahe il-lallah.*

*Është emri i Zotit tonë
Është shija e gojës tone,
Është kujtimi i zemërës tonë
La ilahe il-lallah.*

*Në thelbin e katër librave
Në fjalën e të dashuruarit,
Në fytyrën e Muhamedit a.s
La ilahe il-lallah.*

*Kjo është fjala e të dashuruarit
Edhe dita e netëve
Fjala e ëmbël e Allahut
La ilahe il-lallah.*

Me gëzimin dhe mirësin, sejcili pelegrin u largua duke marë uratën e baba Sakos dhe besimin e patundur në tarikatën bektashiane. Fjala e ëmbël e Allahut do të mbetet ndër gjokset tanë për aq kohë ne do të bëjmë në jetën tonë, atë çfarë kërkon dhe urdhron Ai. Tek e fundit kjo ka qënë dhe mbetet një nga porositë më të vyera që ka dalë prej shpirttrave të dervishave dhe baballarëve bektashinj.

Koresp. "Urtësia bektashiane"



Tradita Bektashiane mahnit Parisin

Mbresa nga shfaqja "Ditët e kulturës bektashiane" që u zhvillua për të tretin vit rradhazi në "La Palas" në kryeqytetin e kulturës botërore



Më 28 maj 2018, Selia e Shenjtë Bektashiane, në bashkëpunim me Ambasadën e Shqipërisë në UNESCO, si dhe shtëpinë botërore të sufijve, organizon "Ditën e kulturës bektashiane" në praninë e një numri të madh artdashësish nga Franca, Italia, Turqia dhe Shqipëria. E konceptuar si një veprimtari në nder të poetit të madh kombëtar Naim Frashëri, dita e kulturës bektashiane

sintetizoi qartë marrëdhëniet e besimtarit me Zotin dhe atdheun, përmes ideve të recitimeve apo këngëve të ndryshme burimore. Ndërsa tradita shekullore bektashiane pasurohet me elementë artistikë të kombeve e kohërave të ndryshme, çelet edhe një dritare përmes së cilës artdashësit parizien mund të shijojnë pasurinë shpirtërore të këtij tarikati të Islamit të sotëm.

Një ftesë e Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Paris, z. Qëndrim Gashi është pritur me kënaqësi nga Selia jonë e Shenjtë. Së bashku me Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, shkojmë në mjediset e Ambasadës dhe pritemi me plot dashuri. Është z. Gashi i cili na uron mirëseardhjen duke u ndalur në kontributin e spikatur të bektashinjve në lëvizjen kombëtare shqiptare në krejt trevat tona në Ballkan. Njëherazi ai shprehet se tarikatet, sidomos në Kosovë, i kanë ruajtur dhe zhvilluar traditat e tyre në harmoni të plotë me njeri-tjetrin, duke i shtuar Islamit bukurinë shpirtërore.

Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian e falënderoi Ambasadorin Gashi për ftesën dhe i uroi punë të paqme në misionin e bukur por të vështirë të diplomatit. Sigurisht, u shpreh Kryegjyshi Botëror Bektashian, veprimtaria diplomatike e faktorit shqiptar në Europën e sotme është në përballje me mjaft vështirësi e problematika të shumëllojshme. Por në pikëpamje të tolerancës dhe harmonisë fetare, ne mbetemi shembull për gjithë familjen europiane. Gjithashtu, Kryegjyshi Botëror Bektashian, dha idenë që në veprimtaritë e ardhshme të ditës së kulturës bektashiane, të shihej mundësia reale për një bashkëpunim midis Selisë



së Shenjtë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në orën 18:00 të datës 28 maj, kanë ardhur në "La Palas" bashkatdhetarët e parë. Të njoftuar nëpërmjet rrugëve të sotme elektronike, ata duan sigurisht të takohen me artistët bektashianë, të çmallen me ta. Stefan Xhuveli është nga Tërbaçi i Vlorës. Ai i njeh së afërmi pjesëtarët e grupit polifonik bektashian dhe me sinqeritetin e një fëmije i fton ata t'ia marrin këngës së bashku. Aty pranë "La Palas" iso burrërore derdhet rrugëve dhe njerëzit e rastësishëm që kalojnë tundin kokat të habitur nga veshja dhe zëri i këngëtarëve tanë.

Mes të 'pa duruarve' të kësaj shfaqje është dhe Luan Rama, studiuesi i letrave shqipe dhe franceze, i cili kohë më parë ka shërbyer në Paris si Ambasadori ynë. Ai ka sjellë me vete dhe një poezi të shkruar si meditim për baba Mondin, i cili duke ndjekur një valle koreografike afrohet natyrshëm me historinë e shkuar përmes një thellësie prehëse mendimi. Ne na pëlqen kjo ide dhe i lutemi Luanit ta recitojë poezinë, duke menduar sigurisht se me spontanitetin e saj mund ta zbukuroj më tej 'ditën tonë të kulturës'. Ndërsa znj. Karol Latifa nga India, duke falënderuar baba Mondin për organizime të tilla madhështore të tarikatisë bektashian, shpreh dëshirën të japë kontributin e saj në rolin e konferencieres, apo të përgatitjes së mizanskenave të shfaqjes. Me humorin e vet karakteristik Kryegjyshi Botëror thotë se shtëpia bektashiane mirëpret çdo njeri. Dyert e bektashizmit janë të hapura kanat, mjafton të duash Zotin në qiell dhe njerëzit në tokë.

Të pranishmit presin me duartrokite ardhjen e Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Paris, z. Gashi, Ambasadorin e Shqipërisë në UNESCO z. Hoxha, si dhe Kryeteren e Komitetit Shtetëror të Kulteve të Shqipërisë zj. Loreta Aliko. Këta, në shoqërinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian ndihen si në shtëpinë e tyre, ndërkohë që

në sfond shfaqet një film-dokumentar i Selisë së Shenjtë Bektashiane. Ka qenë Karola Latifa e cila ka çelur 'ditënë kulturës bektashiane' duke u kujtuar të pranishmëve se për të tretin vit rradhasi, salla e "La Palas" ka pritë artistët virtuozë nga Shqipëria, të cilët kanë shpalosur nëpërmjet folklorit bektashian, vlerat tradicionale historike dhe kulturore të këtij tarikati mistik të Islamit. Paskëta, ajo ka ftuar në skenë Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili midis të tjerave kumtoi: "...Të nderuar të pranishëm, diplomatë, autoritete fetare të feve të ndryshme, artistë të shquar, miq dhe dashamirës të Selisë së Shenjtë Bektashiane. Ju falënderoj sinqerisht jo vetëm për praninë tuaj në eventin e sotëm, por sidomos për kontributin e shquar dhe bashkëpunimin e ngushtë në kuadër të "Ditës Bektashiane të Kulturës". Zoti i Lartë e pranoftë ndihmën bujare që na afroni kaq shqiptarisht dhe dhëntë fat e mbarësi në krejt familjet tuaja! Është i treti vit radhas që mblihdhemi në këtë sallë, për të ndarë së bashku emocionet që na fal ditëlindja e poetit të madh kombëtar të Shqipërisë, mendimtarit dhe vjershëtorit bektashian, Naim Frashërit. Është i treti vit radhas që nëpërmjet kulturës bektashiane 800-vjeçare, ne përçjellim vlerat më të spikatura jo vetëm të trashëgimisë sonë identitare, por edhe të vëllazërisë që besimi ynë ka shpërndarë në këta shekuj të ekzistencës së tij. Ne do të udhëtojmë kurdoherë përmes kësaj tradite, duke bashkuar jo vetëm etnitete kulturore por edhe horizonte shpirtërore. Besimi ynë i mrekullueshëm, në udhëtimin e tij në shumë vite të globit tokësor, është përqaftuar prej miliona besimtarëve për mënyrën paqësore të sjelljes si dhe mistikën hyjnore që përfaqëson. Në këtë udhëtim nga koha në kohë, bektashizmi u shndërrua jo vetëm në burim dialogu të ndërsjelltë, por në mënyrë të veçantë në një filozofi që përhapte ngado shpresë dhe optimizëm për t'u bërë ballë sfidave të jetës. Ka qenë kjo ndër arsyt që bektashizmi, sot e kësaj dite fiton terren të rinj shpirtërorë. Ritet e trashëguar,



Është i treti vit radhas që mblidhemi në këtë sallë, për të ndarë së bashku emocionet që na fal ditëlindja e poetit të madh kombëtar të Shqipërisë, mendimtarit dhe vjershëtorit bektashian, Naim Frashërit. Është i treti vit radhas që nëpërmjet kulturës bektashiane 800-vjeçare, ne përcjellim vlerat më të spikatura jo vetëm të trashëgimisë sonë identitare, por edhe të vëllazërisë që besimi ynë ka shpërndarë në këta shekuj të ekzistencës së tij. Ne do të udhëtojmë kurdoherë përmes kësaj tradite, duke bashkuar jo vetëm etnitetë kulturorë por edhe horizonte shpirtërorë. Besimi ynë i mrekullueshëm, në udhëtimin e tij në shumë vite të globit tokësor, është përqaftuar prej miliona besimtarëve për mënyrën paqësore të sjelljes si dhe mistikën hyjnore që përfaqëson. Në këtë udhëtim nga koha në kohë, bektashizmi u shndërrua jo vetëm në burim dialogu të ndërsjelltë, por në mënyrë të veçantë në një filozofi që përhapte ngado shpresë dhe optimizëm për t'u bërë ballë sfidave të jetës. Ka qenë kjo ndër arsytet që bektashizmi, sot e kësaj dite fiton terren të rinj shpirtërorë. Ritet e trashëguar, tregimet ngjethës së tragjedisë së Qerbelasë, nefeset e shoqëruar me instrumente të çdollojshëm, si dhe këngët e mrekullueshme të polifonisë ballkanase, kanë shoqëruar historinë tonë 800 vjeçare si një dëshmi e pakontestueshme se tarikatet sufi, kanë qenë dhe mbeten shpirti i Islamit. Këta janë padyshim një vlerë e shtuar në mozaikun shumëngjyrësh të universalitetit mysliman.

tregimet ngjethës së tragjedisë së Qerbelasë, nefeset e shoqëruar me instrumente të çdollojshëm, si dhe këngët e mrekullueshme të polifonisë ballkanase, kanë shoqëruar historinë tonë 800 vjeçare si një dëshmi e pakontestueshme se tarikatet sufi, kanë qenë dhe mbeten shpirti i Islamit. Këta janë padyshim një vlerë e shtuar në mozaikun shumëngjyrësh të universalitetit mysliman.

Por do të desha t'ju kujtoja sot, se pikëtakimet e kombit francez me bektashizmin, nuk mund të jenë meritë e sotmja, e jona. Të paktën qysh prej dy shekujsh, autorë të vjetër francezë kanë hulumtuar në arkiva, duke nxjerrë në pah tiparet më domethënës të besimit tonë nga Azia në Europë. Ndërsa sa i përket bektashizmit në Shqipëri, emra të shquar si: Luiz Zharrej, Degrand, Albert Mousset, Justin Godart, Edvin Zhak, Iren Melikov deri tek Natali Kler dhe Lor Kambo së fundmi, kanë vizatuar me penelata plot dritë mozaikun shpirtëror bektashian. Ne u jemi mirënjohës këtyre autorëve që e kanë panë këtë tarikat të Islamit me sytë e zemrës. Unë jam besimplotë se kultura bektashiane, duke rrjedhur përgjatë shekujve në rrjedhën e gjerë të traditës sufi, brenda universit Islam, do të jetojë gjatë. Ajo do të vijë duke u pasuruar sepse vetë bektashizmi ka frymë dhe tendenca bashkëkohore. Ne kemi qenë e mbetemi jo vetëm për të mbështetur paqen universale, por edhe për inkurajimin e çdo përparimi moral dhe social, në mënyrë të veçantë kur sot në botë fryjnë erëra të rrezikshme ekstremizmi.



Ne jemi të vendosur në barrikadën e popujve kundër çdo lloj dhune dhe kundër çdo lloj terrorizmi. Ne mbetemi ndërtues të urave të paqes, duke u ngritur mbi çdo realitet gjeo-fetarë. Edhe një herë faleminderit të gjithëve! Falënderim i veçantë i shkon sot vëllait tonë Aziz Vardar për çfarë bën për ne!

Zoti ju bekoftë të gjithëve!”

Ndërsa përshëndetja e Kryegjyshit Botëror Bektashian është pritur me duartrokitje, Ambasadori i Shqipërisë në UNESKO, z. Ferit Hoxha, në fjalën e vet nënvizoi idenë se veprimtari të tilla kanë role të shumëfishta. Veçanërisht duke u njohur me tolerancën dhe zhvillimin e bektashizmit dhe sidomos me qëndrimet e tij të hapura kundër çdo lloj ekstremizmi islamik,





parizienët e sotëm, ata që janë në këtë sallë, do të mund të formulojnë koncepte të tjera për Islamin, përfundoi ai. Ndërsa Ambasadori i Kosovës, z. Gashi, pasi falënderoi Kryegjyshin Botëror Bektashian për ftesën, u shpreh midis të tjerave se veprimtari të tilla jo rrallë mund të farkëtojnë lidhje e miqësi që diplomacisë do t'i duhen vite për t'i realizuar.

Me kureshtje u ndoq edhe fjala e zj. Loreta Aliko, e cila në një frëngjishte korrekte tha veç të tjerave se Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me qendër në Tiranë, ka një shekull që shpërndanë jo vetëm urtësinë e saj tradicionale por edhe një ndjenjë vëllazërie të fuqishme, duke ndikuar në harmoninë fetare në Shqipëri, Ballkan e më gjerë.

Pjesa e dytë e kësaj veprimtarie u çel me zërin e mrekullueshëm të sopranos së njohur shqiptare Blertha Zhegu, e cila interpretoi këngë të vjetra qytetare shqiptare. E mirëpritur tanimë në skena të vendeve të tilla si Italia, Franca, Spanja dhe Austria, ajo do të përcillte tek të pra-

nishmit emocione të mëdha, duke fituar dhe admirimin e tyre të sinqertë. Zëri melodioz i Zhegut u pasua nga grupi "Shpirti i dervishëve", i përbërë nga këngëtarë turq e marokenë, por i udhëhequr artistikisht nga këngëtarë mistik aq i kërkuar në Paris, tiranasi Enris Qinami. Dy nefese bektashiane me tekst të poetit të parë bektashian Jonuz Emre mbushën me lirizmin e thellë sallën, të shoqëruar me motive dhe instrumente të bardëve bektashianë, për t'ia lënë vendin paskëtaj ilahisë për ngjarjen në Qerbela. Emri i Imam Hysenit u përcoll me dhimbjen e thellë dhe disa prej të pranishmëve çuditen se si kjo dramë njerëzore vjen përmes shekujsh me një narrativë kaq ngjethëse.

Pianistja e shquar Laura Cambay solli përmes lojës së saj autorë shqiptarë, prej të cilëve është frymëzuar jo pak në krijimtarinë e vet artistike. Ajo ka në përfundim një libër poetik rreth bektashizmit dhe kjo bën që notat mistike të ndërthuren natyrshëm me krijimtarinë e kompozitorëve. Edhe recitimi i fragmentit të poemës "Bagëti e bujqësi" të Naimit tonë, u vlerësua përmes duartrokitjeve të të pranishmëve.

Në fund të këtij eventi ishte grupi polifonik bektashian "Fladi i Ehli-Bejtit" i cili me harmoninë e zërave të trondit. Koloritet zanore sjellin ngjarje e personazhe të njohur të bektashizmit, në të cilat shpërfillen kufijtë e vendeve dhe të kohës. Nefeset bektashiane të dala nga goja e këtyre këngëtarëve virtuoz, janë emblema madhështore e traditës sonë. E kuptoj se shumë nga të pranishmit në sallë, nuk mund të kuptojnë tekstin e këtyre nefeseve, por drithërima e zërave, ujëvarat e isove dhe shpërthimi i ndijimeve hyjnore, i mrekullojnë ata, i marrin për dore, duke u treguar universin e papërsëritshëm bektashian.

Syrja Xhelaj,
Paris, maj-2018



Poezi nga Flutura Balla

Mos më zgjo

E dehur ne aromen Tende
Trendafili im...
Vetem Ty te veshtroj
Thelle ne shpirtin tim.
Ke shtruar petalet ne zemer
Ku rruga me con tek Ti,
Si zog i trembur... eci
Se mos te te...humb... por
Ti mos le... e mos me braktis
Se fryme une nuk marr
Pa frymen Tende.
Ti mos me lesho!
E nga harresa ime
Cdo mengjes me petalet e tua
Ne gji me mbaj shtrenguar
E mos me zgjo ne kte jete....!

Në Tomorr

Me dijen perqafuar
Me hene te ndricuar
Ne mal te Tomorrit
Vallezuar....
Me trup e shpirt,
Ne cuke te Tomorrit
Dalldisur mes malesh,
Me bukuri hyjnore
Mes endrrash
dhe tyrbesh rrethuar.
Nga zjarri dashurise
Perverluar...

Do të kthehem serish

E ankoruar ne nje pjesez te tokes
Ndodhem.... perkohesisht
Si anija ne udhetim
Pres te lundroj serish
Nuk di nga vij dhe ku po shkoj
Por di... qe tek Ti
Nje dite do kthehem serish !

Merrmë me vete

O Zoti im
Merrme me vete dhe me co
ne nje tjeter bote.
Aty ku trendafili, ka aromen Tende
Aty ku celiñ manushaqet
Dhe vesa freskon barin
Me uje te argjente
Merrme dhe mos me ndaj
nga dashuria jote
Aty ku ylli mengjesit, sjell agimin
E dielli largon rete..

Dritën mos e fik

Dikur isha une dhe nuk te shihja TY
Tani...
Me syrin Tend shoh
gjithesine...
Me doren Tende ndiej
miresine...
Ne shpirtin tim ku jemi dy...
Ne boten e pafund
Une edhe...Ti.
Nje cast nga Ti largohem
E vuajtja me mberthen....
Si zog perpelitem
Te kthehem tek Ti
Te ik nga Ti...
E si te mundet valle
Shpirti im te jetoj pa Ty
Ne dallget e jetes ne veshtiresi?
Ti mos me le...
E driten mos e fik...
Brenda shpirtit tim

Asgjë nuk më ndan

O i Madhi Zot...
 Dashuria ime je Ti
 Energjia ime je Ti
 Lumturia ime je Ti
 Bukuria ime je Ti
 Embelsia ime je Ti
 Miresia ime je ...Ti
 E dua me teper
 Ne kete bote ?
 Asgje nuk me ndan nga...Ti.
 Të lutem pranomi dhimbjet
 dhe lotët,
 në të dy botët.

Me dorën tënde

O dashuri e madhe hyjnore
 Ti zemren ma ndricon
 O... Udherrefyesi im
 Ti jepme fuqine
 Me doren tende
 Te ndihmoj njerezine...
 Me ndjeshmerine tende
 Te meshiroj njerezine
 Ure te behem per njerine
 Te jem nje me Muhamet Aline

Myrshidit tim

O Zot... te thirra
 e pergjigje ne zemer me dhe
 Mora udhen per tek ti
 Udhen per Bektash Veli
 Shtruar ish me trendafila
 Kenges ja merrnin bilbilat.
 Kur trokita ne ate porte
 Brenda mu pergjigje Ti
 Bente drite muri konakut
 Ku ish ulur prane oxhakut

Aty kandilat merrnin vallen
 Dashuruar me sorkadhen
 Eja me the ! Mos ki frike !
 Ne shtepine tone...ti je veç mik
 Miku i Zotit eshte miku jone
 Eja Flutur ne shtepine tone !
 U cel drita ne shpirtin tim
 Erdha o Zot gjeta shtepine !

Zemrën hapur dashuria

Erdhi hena e Muarremit
 Mblidhen njerezit mbajne zine,
 Per martiret e Qerbelase
 Qajne per nipin e Mustafase.
 Ah Jezit, Jezit mavria
 Mallkim te dha Perendia,
 Nje pike uje nuk e leshoi
 Buzet thare tek çilimija.
 Edhe djalli lot leshoi
 Kur pa gabimin e tija,
 Mori udhen dhe vrapoi
 vendin gjeti te Muavija.
 O Hysein Hysein shehidi
 Ishe dhimbje e profetit,
 Si pasues i Ehlji Bejtit.
 Muavise nuk ju dorzove
 Shpirtin në xehnet e çove,
 Ah Hysen zeri drejtesise.
 Trim mbi trimat e Hyjnise.
 Kush ka vaj le te vajtoje,
 Pas Hyseinit le ti shkoje,
 E ndricon vete Perendia
 Zemren hapur dashuria.

Ditë paqëtimi dhe shprese



Përmirësimi i pjesshëm i infrastrukturës rrugore që të çon në Qesarakën e largët të Kolonjës, ndryshe nga viti paraardhës, lehtësoi disi vargun e gjatë të automjeteve dhe pelegrinëve që mëngjesin e 7 qershorit të këtij viti, kishin si destinacion këtë teqe të njohur bektashiane. Në fakt, atmosferën e ndjesisë shpirtërore të rritjes së besimit tek udha e Haxhi Bektash Veliut, tek Krijuesi, e konstaton edhe tek shumë besimtarë të tjerë që kanë zgjedhur ardhjen në Qesarakë një ditë më parë, duke kaluar natën në mjediset e teqesë dhe në çadrat e ngritura enkas për këtë eveniment. “Prej dy ditësh, pra që dje, mjediset e teqesë e rreth saj, janë kthyer në një qytezë nga besimtarë bektashianë të të gjitha moshave, që kanë ardhur nga fshatrat për rreth, nga Kolonja, Korça, Skrapari, Vlora, Tirana e deri nga vendas me banim jashtë Shqipërisë. Ne jemi përpjekur me aq sa kemi mundur, që kjo ditë e shënuar të kalojë në një paqe shpirtërore sa më të ndjerë, në një klimë miqësie,

dashurie, respekti e shprese tek Zoti”- shton mes të tjerave Nuri Meçollari, kujdestar i teqeve të zonës.

Ndërsa Kryegjyshit Botërorë Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në këtë rrugëtim që nga orët e para të mëngjesit, i është dashur të ndalojë shpesh, të takoj e kuvendoj me besimtarë të shumtë, të cilët nga bekimet e bisedat me ‘të, gjejnë paqe dhe shpresë për vetenm e tyre, familjarë e të afërm...

Siç është dhe tradita në ditën e pelegrinazhit, në orën 11:00 të ditës, u mbledhën në sheshin para godinës kryesore të teqesë, për të ndjekur përshëndetjen e rastit nga Kryegjyshi Botëror Bektashian. Dede Edmond Brahimaj, ndër të tjera pohoi: “Është nder e kënaqësi për mua që të jem sot mes jush dhe t’ju uroj të gjithëve shëndet, mbarësi, paqe e dashuri. Zoti ju bekoftë të gjithëve! Teqeja e Qesarakës mbart në vete një histori të lavdishme. Kjo histori është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me ndërgjegjen morale dhe kombëtare të popullit të Kolonjës, si edhe me aspiratat

për liri dhe pavarësi, të cilat ai i ka manifestuar ndër dekada dhe shekuj ... Emri i kësaj teqeje, lidhet me Haxhi Baba Qesarakën dhe vël lanë e tij shpirtërorë Ali Babai. Ata u vendosën në këtë vend të bekuar rreth vitit 1600, duke ndërtuar konakët e parë dhe duke përhapur në këto treva frymën liridashëse dhe tolerante të Haxhi Bektash Veliut. Në shekujt që erdhën paskëtaj, dervishët dhe baballarët bektashianë jo vetëm mëkuan dashurinë për Zotin e Madhëruar, por edhe virtytet më të larta morale dhe hyjnore, duke bërë dritë në natën e gjatë të përgjumjes otomane. Fatkeqësisht, në vitin 1967, në atë vit të mbrapshtë, teqeja u mbyll dhe u kthye në magazine bari të ish-kooperativës bujqësore. Por edhe pse persekucioni ishte konstant dhe i egër, besimtarët vendas, në mënyrë ilegale, jo vetëm kryenin ritet e besimit tonë të nderuar bektashian, por transmetonin dhe fëmijëve të tyre nevojën e besimit në Zot, bashkë me shpresën se në një të ardhme të afërt, do të vij dita që teqeja të hapë dyert. Falë proceseve demokratikë pas vitit 1990, edhe në Kolonjën tonë martire nisi ringritja e tyrbeve dhe teqeve. Është e pamundur të flasësh për ringritjen e kësaj teqeje dhe të mos sjellësh sot ndër mend, kontributin e çmuar të babait të kësaj teqeje, të birit të urtë e të dhemshur të këtij vendi, klerikut Baba Xhemal Shkëmbi. I ardhur prej një fisi, i cili ka qëndruar përgjatë shekujve në ruajtje të traditave bektashiane, baba Xhemal Shkëmbi, duke pasur kurdoherë uratën e dede Reshatit, por edhe ndihmën e gjyshitës së Turanit, mundi të grumbullojë en-


ergji dhe forca të mëdha dhe arriti të ngrejë këtë teqe të bukur, në gjoks të bukurive të natyrës. Merita e tij, qëndron veç të tjerave në faktin se ai e ringriti teqenë e Qesarakës, mbi themelet e vjetra, duke ruajtur në këtë mënyrë jo vetëm pamjen e jashtme të saj, por sidomos frymën dhe traditat tona të mrekullueshme. Nderime të përgjeshme baba Xhemalit! Prandaj sot, emri i tij përmendet me krenarinë e ligjshme, sepse ishte dhe mbeti klerik i përvuajtur në ruajtje të vlerave më të mira bektashiane. Unë dua të shtoj këtu se një meritë të veçantë për masat që janë marrë dhe kushtet që janë krijuar për mbarëvajtjen e pëlegrinazhit të sotëm, ka dhe

kujdestari i teqeve gjyshitës Korçë, Nuri Muçollari, të cilin unë e falënderoj. Unë, në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, sot dua tu falënderoj për ardhjen tuaj në këtë ditë të bekuar të pelegrinazhit, me shpresën se përherë e më shumë, oborri i kësaj teqeje do të gumëzhijë nga prezenca në rritje e besimtarëve. Ju uroj të gjithëve dashuri, paqe, mirësi për ju e familjet tuaja! Zoti ju ndihmoftë!”

Minutat dhe orët kalojnë si pa u ndjerë. Një drekë tradicionale bektashiane në natyrë, shoqëruar me biseda të shumta, nefese e këngë bektashiane, ja shtuan më tej bukurinë shpirtërore të kësaj dite..



Vëllazëri e përjetshme



Baba Fetah Xhelaj nderohet (pas kalimit nga kjo jetë) nga Presidenti i Republikës z. Meta me titullin e lartë “Naim Frashëri”

Fshati Kolonjë në Gjiro-kastër festoi me madhësi ditën e shënuar tradicionale të “10 majit”, në rrapin shekullor, në qendër të fshatit, kishin ardhur nga gjithë zona e Kurveleshit, Gjirokastra, Skrapari, Tepelena, Fieri, Durrësi,

Tirana, gjithashtu edhe emigrantët e fshatit nga Greqia, Italia, Franca e vende të tjera, të cilët i dhanë gjallëri e mall kësaj feste të mrekullueshme. Qysh herët në mëngjes radha e pelegrinëve u ngjit në pllajën e malit mbi Kolonjë drejt tyrbes të baba Fetahut te Lisi i

Çikës, kështu e kishte lënë amanet kleriku i shquar për banorët e fshati të tij se kur të më kujtoni më kini te “Lisi i Çikës”. Mbas viteve '90 besimtarët e dashamirësit i ngritën me këtë amanet tyrben e tij te lisi, tashmë e vizituar nga qindra pelegrinë në çdo kohë.

Mori pjesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta dhe Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Në mesin entuziazmit përshëndeti presidenti Z. Ilir Meta, i cili duke vlerësuar lart këtë figurë të shquar me medaljen e Naim Frashërit, midis të tjerave ai tha: “Sot pata kënaqësinë të merrja pjesë në festën tradicionale të Kolonjës në Kurvelesh, që çdo 10 maj përkujton e nderon figurën e baba Fetahut, patriotit e udhëheqësit të shquar fetar, i cili frymëzoi besimtarët e të gjithë kolonjarët, me dashurinë për atdheun, lirinë dhe me besimin te Zoti.

Në vlerësim të veprimtarisë patriotike për përhapjen e gjuhës e kulturës shqipe, si dhe në organizimin e luftës kundër pushtuesve të vendit, pata privilegjin të vlerësoja sot këtë personalitet me titullin “Naim Frashëri”. Nder dhe lavdi dëshmorëve të Kolonjës, të Kurveleshit, të Labërisë dhe të gjithë Shqipërisë! I përgëzoj që kanë ruajtur e mbajtur gjallë me kaq dashuri e pasion traditat e të parëve të tyre fisnikë!”

Më pas Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve falenderoi Presidentin Meta për vlerësimin në vijim të klerikëve bektashian dhe kontributin e veçantë të baba Fetahut. Midis

të tjerave kujtoj se në vitin 1937 komisioni i festimeve të 25 vjetorit të shpalljes pavarësisë i bënte këtë vlerësim: “Baba Fetahu. Midis të tjerave i teqesë së Backës ka qenë një nacionalist i dëgjuar në qarkun e Skraparit dhe ka punuar me zell patriotik për realizimin e idealit kombëtar. Pak ditë pas lidhjes së Prizrenit ka vënë në portën e teqesë së Backës gurin e gdhendur me shqiponjën dy krenore duke u thënë popullsisë së atij rrethi se ky zog një ditë do të jetë flamuri i Shqipërisë. Kjo shenjë ndodhet edhe sot në portën e kësaj teqeje. Komisioni vendosi pagëzimin e shkollës Radëshit me emrin e tij.”

Por vitin që vjen baba Fetahu ka 200 vjetorin e lindjes dhe për

ta festuar këtë event sa më mirë nga Selia e Shenjtë Bektashiane si edhe Gjyshata e Gjirokastrës po merren një varg masash, për të hedhur sa më shumë dritë në veprën e baba Fetahut, e cila padyshim lidhet me lëvizjen e madhe bektashiane në jugun e Shqipërisë, në shekujt 19 dhe 20. Pelegrinazhi kaloi gjithë ditën me gëzim dhe ngohtësi vëllazërimi në gjithë veprimtaritë e tjera të kësaj ditë. Pelegrinët muarën gëzimin e kësaj dite të mrekullueshme, muarën mirësinë dhe vëllazërinë e besimit bektashian. Kjo vëllazëri e përjetshme besimi sjell vetëm dritë dhe shpresë.

Koresp. “Urtësia”



Emblema të historisë së kombit



Ifturar nga shoqata mbarëkombëtare kulturore “Dardania” si edhe bashkia e qytetit të Vinterthurit-Zvicër, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj mori pjesë këto ditë në inaugurimin e shtatores të Shënjtores Nënë Terezë si edhe në konferencën përkujtimore në nder të Gjergj Kastriot Skënderbeut. Ai u prit së pari nga kryetari i shqatës “Dardania” për Zvicër, z. Shevqet Cakolli, i cili e falenderoi Kryegjyshin Botëror Bektashian, që iu përgjigj ftesës

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në inaugurimin e shtatores të Shënjtores Nënë Terezë si edhe konferencën përkujtimore për Skënderbeun në Vinterthur të Zvicrës.

dhe e njohu atë me veprimtaritë kulturore dhe atdhetare në vijimësi. Më tej e njohu me programin e eventit në fjalë, duke u ndalur sidomos në përpjekjet e mëdha për vendosjen e shtatores Nënë Terezë, në një prej parqeve në qendër të qytetit të vogël e piktoresk të Vinterthurit.

Në këtë bashkëbisedim të ngrohtë, thuajse vëllezëror, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i falenderoi organizatorët e eventit duke përcjellë urimet më të mira për ta dhe familjet e tyre. Ai tha se nisma të tilla që evokojnë ngjarjet kulturore të historisë së kombit tonë, padyshim i bëjnë nder jo vetëm gjeneratave të djeshme, por edhe këtyre të sotme dhe nesërme, sepse në fund të fundit ne duhet të dijmë nga kemi ardhur, për të hedhur hapa të sigurtë në të sotmen. Për më tepër, kur veprimtari të tilla lidhen me dy prej figurave legjendare të kombit, Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe Shënjtores Nënë Terezë, atehere mbresat e përfuara janë të mëdha dhe të skalitura në kujtesë.

Në orën 17 të datës 2 qershor 2018, ne iu drejtua sheshit ku ishte vendosur shtatorja të shoqëru-

ar prej qindra shqiptarëve me banim në Zvicër. Aty, Kryegjyshi Botëror Bektashian e presin veç të tjerëve, Ambasadori i Shqipërisë në Zvicër, z. Ilir Gjoni, Ambasadorja e Kosovës znj. Nazane Breca, drejtori qendrës kulturore të Kosovës në Zyrih, z. Ridvan Murati, përfaqësuesi kishës Katolike të Kosovës dom Lush Gjergji si edhe të ftuar të tjerë. Ata e falenderojnë kreun botëror të bektashinjve për pjesmarrjen në këtë event, duke kujtuar se misioni i Selisë së Shenjtë Bektashiane, në kontekstin e harmonisë dhe tolerancës fetare në Ballkan e më gjërë, sa vjen e rritet. Ne jemi krenarë, u shpreh dom Lush Gjergji që kemi në Tiranë, Selinë e Shenjtë Bektashiane dhe unë besoj se baba Mondit po ecën në gjurmët më të mira të të parëve të vet, duke mos i ndarë në asnjë moment ndenjat fetare nga ato kombëtare.

Pas zbulimit të shtatores së Shenjtores Nënë Terezës, të punuar mjeshtërisht prej skulptorit Bashkim Beqiri, përshëndeti së pari Kryetari i Bashkisë së Vinterthurit, i cili tha midis të tjerave se jo vetëm ky qytet, jo vetëm Zvicra e Shqipëria, po ky akt vlerësimi mund të nderonte çdo vend të botës së sotme. Sepse çdo vend, ka nevojë të ketë sa më shumë simbole të dashurisë dhe mëshirës. Përshëndeti paskësaj Imami i xhamisë në Vinterthur, dom Lush Gjergji etj., të cilët hodhën dritë mbi disa prej tipareve më ta vyer të Shenjtores Nënë Terezë. Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, solli në vemendjen e të pranishmëve 22 marsin e vitit 1991, ditën e parë të çeljes zyrtarisht të Selisë së Shenjtë Bektashiane, pas asaj



Rruga e gjatë e jona, plot dhimbje e drama, qysh nga ngjizja identitare e deri në ditët e sotme, është padyshim një sagë e lavdishme. Në këtë rrugëtim, përgjatë shekujve, dheu dhe fryma liridashëse e Dardanisë nxuarën burra e gra dinjitate, të cilët me veprat që lanë, kapërxyen krejt natyrshëm kufijtë që na pati dhuruar Zoti i Lartë, duke shpërndarë shenjtërinë e etnisë sonë, prej Europe deri në Indinë e largët. Në panteonin e kësaj yllësie, ndrijnë padyshim emrat e Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe shenjtores Nënë Terezë, duke na bërë të ndihemi krenarë sot e gjithë shekujt në vijim, për çfarë ndamë me mirësitë e kësaj bote.

periudhe të vështirë të ateizmit të skajshëm. “ Zoti i Lartë solli Nënë Terezën atë ditë në shtëpinë e Haxhi Bektash Veliut, në Selinë e Shenjtë Bektashiane për të na uru-

ar dhe bekuar, për të na dhënë shpresa dhe energji të reja, në udhëtimin tonë për ringritjen nga themelet të objekteve të kultit”.

Ndërsa konferenca përkujtimore rreth dy figurave të historisë dhe krenarisë sonë kombëtare, Gjergj Kastriotit dhe Shenjtores Nënë Terezë, u zhvillua në një rën prej sallave madhështore të hotelit në qendër të Vinterthurit. I konceptuar si një event artistik dhe përkujtimor, aty u ndërthurën krejt natyrshëm përshëndetjet e të ftuarve nga Shqipëria, Kosova e

Zvicra, me këngët, vallet dhe recitimet e mrekullueshme të artistëve dardanë. Në fjalën e tij, Kryegjyshi Botëror u shpreh midis të tjerave: “E prita me kënaqësi të veçantë

ftesën e shoqatës kulturore “Dardania” me seli në Vinterthur dhe më lejoni t’ju uroj në emër të milona besimtarëve bektashinj, në të gjithë botën. Paçi fat e mbarësi në jetët tuaja dhe të familjeve tuaja! Zoti i Lartë ua shpërbleftë devocionin tuaj përkujtimit të dy figurave emblematike në historinë e kombit tonë.

Rruga e gjatë e jona, plot dhimbje e drama, qysh nga ngjizja identitare e deri në ditët e sotme, është padyshim një sagë e lavdishme.

Në këtë rrugëtim, përgjatë shekujve, dhe fryma liridashëse e Dardanisë nxuarën burra e gra dinjitare, të cilët me veprat që lanë, kapërxyen krejt natyrshëm kufijtë që na pati dhuruar Zoti i Lartë, duke shpërndarë shenjtërinë e etnisë sonë, prej Europe deri në Indinë e largët. Në panteonin e kësaj yllësie, ndrijnë padyshim emrat e Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe shenjtores Nënë Terezë, duke na bërë të ndihemi krenarë sot e gjithë shekujt në vijim, për çfarë ndamë me mirësitë e kësaj bote.

Gjergj Kastriot Skënderbeu, i edukuar qysh në rininë e hershme të tij, me traditat e vyera

bektashiane, nguliti thellë në shpirt idenë e lum e se “Pa atdhe nuk ka fe”. Ky shpirt i lirë, ky burrë i Shqipërisë, ky trim dhe diplomat, me jetën dhe veprën e tij monumentale, rrëfeu veç të tjerave se nata e robërisë osmane, nuk mund të bashkëjetonte me principet e lirisë dhe mëvehtësinë të kombit tonë, përkundrazi këto do të ishin në luftë për jetë e vdekje më njera-tjetrën. Një çerek shekulli lavdie e Arbërisë

Gjergj Kastriot Skënderbeu, i edukuar qysh në rininë e hershme të tij, me traditat e vyera bektashiane, nguliti thellë në shpirt idenë e lum e se “Pa atdhe nuk ka fe”. Ky shpirt i lirë, ky burrë i Shqipërisë, ky trim dhe diplomat, me jetën dhe veprën e tij monumentale, rrëfeu veç të tjerave se nata e robërisë osmane, nuk mund të bashkëjetonte me principet e lirisë dhe mëvehtësinë të kombit tonë, përkundrazi këto do të ishin në luftë për jetë e vdekje më njera-tjetrën. Një çerek shekulli lavdie e Arbërisë të asaj kohe, ishte shembulli më i shkëlqyer i shpirtit tonë liridashës. Gjergj Kastrioti dëshmoi ndërkaq edhe vendosmërinë e shqiptarëve ndaj kontinuitetit të tyre shpirtëror kristian.



të asaj kohe, ishte shembulli më i shkëlqyer i shpirtit tonë liridashës. Gjergj Kastrioti dëshmoi ndërkaq edhe vendosmërinë e shqiptarëve ndaj kontinuitetit të tyre shpirtëror kristian.

Shekuj më vonë, shënjtoria Nënë Terezë, Gonxhja e viseve shqiptare, do të merrte mbi vete një prej misionëve më egzistencialë të frymës fetare, atë të mëshirës universale që vjen prej mësimëve të gjithë librave të shenjtë. Tamam si për të dëshmuar tolerancën dhe harmoninë e mrekullueshme të feve dhe besimeve në territoret shqiptare, ajo grua e pakët nga trupi por aq e madhe nga shpirti, u shndrrua në mal të shpresave për mijra të sëmurë, të uritur, të goditur nga plagët e hapura të kësaj bote. Emri i saj, do të mbetet pa më të voglin dyshim, sinonim i butësisë njerëzore dhe hyjnore përballë realiteteve të egër që po kalojmë sot.

Të nderuar të pranishëm!

Eventi i mrekullueshëm i sotëm, i cili mëton të respektojë dy figura të ndritura të kombit tonë, nuk mund të jetë thjeshtë një akt vlerësimi, ndaj historisë. Veçanërisht këto ditë, kur Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia po punojnë vrullshëm për t'u bashkuar familjes evropiane, kjo veprimtari na kujton të gjithëve se shqiptarët kanë qenë dhe do të mbeten pjestarë të denjë të kësaj familjeje jo vetëm shpirtërisht por edhe fizikisht. Ne po

dëshmojmë se do të hyjmë në ato dyer qytetërimi me identitetin tonë fetar, moral dhe kulturorë.

Ju faleminderit të gjithëve! Zoti ju bekoftë! Amin!"

Gjatë ditëve të këtij aktiviteti mbresëlënës, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u prit vëllazërisht edhe nga përfaqësues të komunitetit bektashian shqiptar që jetojnë prej dekadash në Zvicër.

Ata rrëfyan se si edhe midis prioriteteve të metropolit, gjejnë kohë për të ushtruar ritet bektashiane, sipas traditave më të mira të teqeve bektashiane. Nuk kanë munguar ndërkaq edhe festimet masive në ditën e Sulltan Novruzit. Siç nuk kanë rreshtur për asnjë çast takimet dhe leximet tradicionale të "Hadikasë" në ditët e matemit, për të vijuar më tej ceremoninë e ashures.

Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror i falenderoi myhibët dhe besimtarët bektashianë, të cilët përmes sakrificash zhvillojnë më tej traditën bektashiane, duke përcjellë idenë se kjo traditë ka jetuar dhe jeton në raporte sa më të paqta me fetë, besimet apo civilizime të tjerë, sepse në thelbin e vet ka devocionin e thellë ndaj Krijuesit dhe dashurinë e pashtershme për njeriun.

Syrja Xhelaj
Zvicër qershor 2018



Ditët që do të vijjnë...


Janë rritur akoma më shumë qershitë në Bubës të Përmetit. Kanë hedhur goxha shtat arrat që i mbollën vëllezërit Zaimi tri-katër vite më parë. Ndërsa mollët e dikurshme, kanë mbajtur fruta më shumë se çdo vit, ndaj dhe Bilbili më thotë se kemi porositur disa trugje për t'ua vendosur degëve që të mbështeten. Bajamet, ndonëse i goditi breshëri i para disa ditëve, duket se nuk e japin veten. Në atë peizazh ngjyrash të ndezura, ato mbajnë në supe kore bilbilash që duket se bëjnë garë me grupin e famshëm të Tepelenës.

Si në çdo ditë pelegrinazhi, nënë Sanija me djemtë na presin tek hyrja. Me buzagazin e përjetshëm, ajo më kujton të mirat, nënat tona që nuk e di çfarë mekanizmash përdorin për të

fshehur brengat dhe për të falur vetëm dashuri e përgjirim.

Dhe sikur të ketë kuptuar krejt ato mendime të mijat, më thotë duke më kapur nga duart: "Nuk plakem unë jo. As nuk bren-gosem dot. E di pse? Nuk më lë baba aliu. Jo t'u bëfsha! Nuk lenë dervishët e baballarët të na qajë buza. Nuk kemi qarë edhe aherë kur ishte kohë tamam për të qarë, maherë kur na rrënuan tyrben. Rrita një vatër me kal-amaj, në punë kooperative, herë me bukë e herë pa bukë. Por prapë, kur vija te baba Aliu fshehurazi dhe i tregoja mezarit me zë të ulët, më bëhej se dëgjoja përmes erërave që më thoshte: Mos u sëkëlldis, duro. Zoti na vë në provë të gjithëve. Lum kush duron!"

Teqeja, si çdo ditë pelegrinazhi



është mbushur plot. Vijne besimtarë që flasin me baba Aliun, sipas kodeve që vetëm ata i deshifrojnë. Por vijne dhe dashamirës, të tillë që e duan bektashizmin, që e kuptojnë se në fund të fundit se ky besim tetëqind vjeçar është një lëvizje e përjetshme për të zbukuruar shpirtin njerëzorë. Këta, me të ardhur në vendin e bekuar, me të shijuar harmoninë e pemëve të mbjella me virgjërinë e natyrës, kuptojnë edhe diçka tjetër, shohin një bukuri që jo rrallë ia kalon edhe bukurive natyrore. Një fjalë, një përshëndetje, një lutje në heshtje apo një bashkim duarsh në valen përmetare të shoqëruar nga



sazet, e nxit këtë dashmirës të rendë një orë e më parë dhe të futet në thellësitë e pamatshme të vëllazërisë bektashiane.

Shekuj më parë, mistiku i famshëm Ikbali pati shkruar se unë e pashë se dita e këtij universi që shtrihet në shumë drejtime e siguronte ekzistencën e saj nga rrotullimi i një planeti dhe zgjaste për aq kohë sa të thuash se ajo u nis. Kjo është një ditë e mbarë që nuk i përket kohës, që nuk ka as drekë dhe as mbrëmje, një ditë, drita e së cilës e ndriçon shpirtin, në sajë të së cilës mund të shihet tingulli ashtu siç shihet ngjyra. Më shkëlqimin e saj, të gjitha gjërat e munguara bëhen të pranishme dhe zgjasin përjetësisht. “Ti je shkëlqimi i përjetshëm, ndërsa ne

u ngajmë shkëndijave, ne qëndrojmë veçse një ose dy çaste dhe përsëri ato na janë dhënë hua. O Ti, që nuk e njeh luftën e vdekjes dhe të jetës, cili është ky rob që lakmon Zotin?. Ky rob i padurueshëm që pushton horizontet? Unë jam jetëshkurtër, bëmë të përjetshëm, unë jam prej toke, bëmë mua prej qiellit. Bëmë të palëkundur në fjalë dhe në vepra. Rrugët janë të dukshme, pranomë që të eci në ‘to... Unë nuk mbajë më shpresë tek mësuesit e kohëve të vjetra. Unë flas për ditët që do të vijjnë.”

Padyshim për seicilin pelegrin të ardhur sot në Bubës, ky vend i bekuar do të skalitet në kujtesë. Sepse në radhë të parë, dita lidhet me kujtimin e mrekullueshëm të

baba Aliut, të atij burri të mençur që përhapri këtyre maleve dritën e Zotit dhe të diturisë. Mandej dita bëhet më e bukur me pritjen e ngrohtë që nënë Sanija, djemtë, nusët, nipërit dhe mbesat e saj u rezervojnë të gjithë pelegrinëve pa asnjë lloj diferencimi, siç ndodh në çdo vend a sofër bektashiane. Pastaj ato këngët e mrekullueshme përmetare që shpërndajnë veç dashuri.

Në ditët që do të vijjnë, për seicilin prej nesh, 15 qershorin do ta kundrojmë si një ikonë paqeje, si një shfaqje të vëllazërisë, si një shpresë që të kemi sa më shumë ditë e net’ të tilla brenda vetes.

Syrja XHELAJ

Bubës-Përmet, qershor 2018

Vepër që do të mbet

“ Presidenti i Republikës z. Ilir Meta dekoron baba Ismail Jangullin (pas kalimit nga jeta) me titullin “Naim Frashëri” ”




Edhe pse rruga e vështirë me një ndijesi të veçantë ngjitesh nga Shupenza, për teqen e Bllacës së Dibrës, e njohur në shekuj, ku teqeja e hershme e baba Isufit të Parë, ka 165 vjetorin e themelimit. Me këtë rast, dita e 24 qershorit u bë më e bukur në ceremonialin e veçantë, ku u dha dekorata “Naim Frashëri”, baba Ismail Jangullit (mbas kalimit nga jeta). Oborri

para teqesë i mbushur plot e përplotë me besimtarë e dashamirës nga Gryka e Madhe, Bulqiza, Martaneshi dhe Tirana, klerikët e ardhur nga teqetë e Shqipërisë, merr pjesë Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësa e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, përfaqësuesit e Presidencës së Republikës zotërinjtë, Blendi Dervishaj dhe Majlind Lazimi dhe përfaqësues të pushteti vendor. Në atmosferën

e këngëve bektashian ndjehet një gëzim i natyrshëm që jep ky vend i bekuar.

Mbas hymnit kombëtar në fjalën e bukur dhe të ngrohtë të hapjes z. Bujar Shehu ftoi sekretarin e teqesë Bllacës, Bektash Jangulli, i cili shtoi: “në evente të tilla, mes emocioneve po ju flas i vetëdijshëm, se baba Ismaili është mesnesh, shpirtërisht. Le ta ruajme pra te pastër “besën bektashiane”

et në breza



ashtu siç na e lanë të parët tanë, dhe siç na porosiste çdo dite baba Ismaili.” Më pas përshëndeti Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, i cili falenderoi Presidentin e Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta për dekorimin e baba Ismailit në këtë ditë të shënuar që është themelimi i teqesë me histori të madhe, e cila në shekuj la gjurmë të vëllazërimit e përhapjes së gjuhës shqipe, atdhetarizmit e gjithë klerikëve që punuan me shpirtë dhe dashurinë e Zotit e mbajtën gjallë këtë teqe më e njohura në Dibër. Vepra e baba Ismailit një jetë e tërë në shërbim të besimit bektashian do të mbetet i paharruar te të gjithë besimtarët dhe klerikët bektashian, ne do të punojmë në udhën e tij, në udhën e Haxhi Bektash Veliut. Vepra e tij do të mbetet në breza të tërë. Në kulmin e ceremonisë përfaqësuesi i Presidencës z. Blendi Dervishaj në

fjalën përcjellse solli kontributin e bektashizmit në shekuj për kombin shqiptar nga rilindja e deri më sot. Ai i dorëzoi Kryegjyshit Botëror dekoratën e baba Ismail Jangullit (mbas vdekjes) titullin “Naim Frashëri” me këtë motivacion: “Për kontributin si udhëheqës i shquar fetar, në vlerësimin të sakrificave për mbrojtjen e traditave më të vyera të besimit bektashian në udhën e Haxhi Bektash Veliut.” Kjo u shoqërua me poezitë e bukura nga nxënëset: Ema Fiku, Eva Kursani, Dallëndyshe Jangulli, Ida Cami dhe Munire Jangulli dhe këngëtarit i njohur i Bulqizës Agim Huma. Atmosfera e mrekullueshme vazhdoi me bisedat e ngrohta ndërsa kujtimi i baba Ismail Jangullit do të mbetet i gjallë në çdo zemër besimtari bektashian.

Koresp. “Urtësia”



PEACE AS A BASE



The evening gathered all those invited – who had contributed particularly in connection to the now obtained believers’ rights – in the milieu of the “Baba-Harabati” tekke. The US Ambassador in Skopje, His Excellency Jess Baily, in his introductory remark, focused especially on the Bektashi contributes to religious tolerance in the Balkans. Affectionate words were offered also by Her Highness, Princess Maria Amor, which was fascinated by Bektashian hospitality and tradition. Whereas the Bektashian World Head, His Gracefulness, Haji Dede Edmond Brahimaj added among other

things: “I am sincerely grateful for your presence here today to share together the wonderful feelings of this day. It is a glorious jubilee of our national hero, George Castriot Skanderbeg, who not only grants us legitimate pride of being Albanians, but also it is reminder to us and to others that our grand-and-great-grandfathers’ aspiration was European. Long centuries of servitude could not alter this our ownmost hope – so, despite our Albanian post-communism – we are conscious that we will soon join our historical family.

We shall consider the recent decision taken these days from the International Court of Strasbourg,

not as a ‘victory over the rival’, but as a delayed right which, of course, will serve not only to religious harmony and tolerance in Macedonia, but also to its development unto the irreversible road toward the values of the European civilisation.

The Bektashian Holy Seat in Tirana carries along a history more than 800 years old, the seeds of which were sown in the first Bektashian tekke, in today’s Neveshehir, Turkey. But all this history has shown is that in spite of the historical conditions, in spite of the wars and confusion, our attitudes and vocation have been capable to raise themselves over sectarian interests and move-

OF BROTHERHOOD

ments, defending religious coexistence through their doctrinal and customs code.

We have always considered it the will of God that we be living among various identities, of course under a common sky and earth, and within this gracefulness knitted by the hand of the Creator, Bektashians have put their mind, heart and their infinite sacrifice toward the act of religious brotherhood.

I assure you, honored guests, that we are going to keep transmitting this wonderful philosophy to the generations to come. To end, I want to say that every kind of coexistence between religions in Balkans and beyond, irrespective of the achieved stages, of the seeming worries or tendencies, should be regarded not as a museal evidence, but as a reality of, and

destined to progress with the will of all of us who pray to one singular God. Otherwise, if we look the faith and tolerance from the point of view of our trenches, then it becomes threatening and keeps us at a distance from the European dream.

The barbaric acts of these times, incited by the politicization of Islam and other extremisms, are yet another reason to join hands, to unify our humanitarian battle according to the best models brought down to earth from the Creator.

I also give my thanks, along with you, to all those religious and political leaders in Macedonia who found time to give your wishes for my birthday, and pray to God to provide me with strength and energy to continue onwards, the great duties of our Holy Seat, to the widespread Bektashian communities around the world. May God bless you all! Amen!"

Upon the round table, in the "Baba-Harabati" tekke, discussion, salutation, and song endured for quite some time.



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.126 QERSHOR 2018

